



Republika e Maqedonisë
Ministria e Drejtësisë

**STRATEGJIA PËR REFORMËN E SEKTORIT GJYQËSOR PËR
PERIUDHËN 2017-2022 ME PLANIN E VEPRIMIT**

1. HYRJE

1.1. Arsyet për miratimin e një Strategjie të re për reforma në sektorin e drejtësisë

Avancimi i sistemit gjyqësor dhe funksionimi i tij paraqet një paralusht kyç për zhvillimin e Republikës së Maqedonisë si një shtet demokratik juridik dhe një shoqëri multi-kulturore e të drejtave dhe lirive të barabarta të qytetarëve dhe për integrimin e saj euroatlantik. Ndërtimi i një sistemi të gjyqësisë dhe institucioneve të pavarura dhe të paanshme që gravitojnë drejt realizimit të funksionit të drejtësisë efektive, cilësore dhe të barabartë, është një postulum qendror i parimit të sundimit të ligjit dhe një zhvillim human dhe i qëndrueshëm i shoqërisë në Maqedoni si një komuniteti i bazuar mbi në të drejtën legjitime duke respektuar vlerat më të larta civilizuese.

Vlerësimet për situatën që arsyetojnë miratimin e Strategjisë lcorrespondojnë me vlerësimet e KE në raportet e progresit të Republikës së Maqedonisë në vitet e fundit, Rekomandimet e grupit të ekspertëve të lartë për çështje sistematike për sundimin e ligjit në lidhje me komunikatat e përgjuara që u shpaleshën në pranverë të vitit 2015, qershor 2015. Rekomandimet e grupit të lartë të ekspertëve për çështje sistematike dhe sundimi i ligjit të shtatorit 2017, reformat urgjente prioritare të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë në qershor 2015, Përgatitja e Programit të BE-së për mbështetjen e sektorit gjyqësor, korrik 2014 (në tekstin e mëtejme MK Vlerësimet), praktika e GJEDNJ e shprehur nëpërmjet gjykimeve kundër Republikës së Maqedonisë, Raporti i GRECO Vlerësimit për Republikën e Maqedonisë – raundi i katërt, dhjetor 2013, Raport mbi pajtueshmërinë e GRECO për Republikën e Maqedonisë – raundi i katërt, korrik 2016, Komisioni Evropian për efikasitetin e

drejtësisë (CEPEJ) – Raport për vlerësimin e sistemeve gjyqësore evropiane dhe efikasitetin dhe cilësinë e drejtësisë – edicioni i fundit në vitin 2016 (të dhënat e 2014), Mendim i Komisionit të Venedikut për ligjet mbi përgjegjësinë disiplinore dhe vlerësimin e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë, në dhjetor 2015, Raportet nga misioni i kryer i vlerësimit në vitin 2012 (Luka Perili Efektiviteti gjyqësori, Xhems Voelg Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit).

Baza për përgatitjen e kësaj strategjie ishte Draft Strategjia për reformën e selectorit gjyqësor, e përgatitur në lcuadër të projektit IPA 2010 "Mbështetje e mëtejshme për gjyqësorin e pavarur, të përgjegjshëm, profesional dhe efilcas dhe futjen e shërbimit të provës dhe sanksioneve alternative" dhe raportet nga IPA projekte të tjera.¹

Përlcundër të gjitha projekteve të reja ligjore dhe institucioneve të reja në sektorin e drejtësisë, inkorporomi në sistemin ligjor të standardeve dhe normave ndërkombëtare, ngel problemi i zbatimit dhe aplikimit të tyre. Rezultatet e arritura në fushën e efilcasitetit të gjyqësorit ngelin në hije për shkak të pavarësisë së saj të humbur, duke rezultuar në një shllcallë të ulët të cilësisë dhe duke shpreh mosbesimin e qytetarëve në institucionet e sistemit të

¹ IPA 2007 – "Mbështetje për funksionimin më efikas, efektiv dhe modern të funksionimit të Gjykatës Administrative"

IPA 2008 – "Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale të Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë"

IPA 2008 – "Zbatimi i Reformave të Drejtësisë për të Mitur" IPA

2009 – "Mbështetje për reformën e sistemit penal"

IPA 2009 – "Ngritja e kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit për trajtimin e duhur të personave të ndaluar dhe të dënuar"

IPA 2010 – "Mbështetje e mëtejshme për gjyqësorin e pavarur, përgjegjës, ekspert dhe efikas dhe promovimin e provës dhe masave alternative"

IPA 2010 – "Mbështetje për parandalimin e efektshëm dhe luftën kundër korrupsionit" IPA

2011 – "Rritja e sundimit të ligjit"

IPA 2012 – "Forcimi i kapaciteteve kombëtare për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" IPA

2012 – "Forcimi i bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale dhe civile"

Organizatat e shoqërisë civile (SHC) lcanë luajtur një rol të rëndësishëm në shoqërinë në Maqedoni gjatë viteve të lcaluara si një faktor kyç i cili lcontribuon në zgjidhjen e lcrizës politilce në vend dhe mbajtjen e standardeve minimale profesionale në sektorin e drejtësisë.

I dulcshëm është trendi pozitiv i koordinimit të forcuar dhe kyçje së rrjeteve të shoqërisë civile me qëllim të pjesëmarrjes së saj në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, sidomos në pjesën reformave në sektorin e drejtësisë. Në fakt, në korrilc të vitit 2017, 73 organizata të shoqërisë civile, akademikë dhe ekspertë të pavarur lcanë lcontribuar në përgatitjen e përmbajtjes në fushën e politikave publike duke prodhuar dokumentin me titull "Propozime të organizatave të qytetarëve për reforma urgjente demokratike", e cila përmban udhëzime dhe alctivitete të hollësishme për vendosjen e standardeve dhe vlerave demokratike, arritjen e përparimit në disa fusha të politikave publike, si dhe rivendosjen e besimit të qytetarëve në institucionet lcryesore shtetërore.

Shoqata e gjyqtarëve si shoqatë profesionale u dëshmuua si një organizatë qytetare shumë e rëndësishme në sektorin e drejtësisë që pati sukses në periudhën e lcaluar dhe e imponoi veten si një falctor relevant i cili e mbajti dinjitetin profesional dhe ekspertizën e gjyqtarëve. Kjo nulc ngeli si gjë e pavërejtur nga ana e bashkësia ndërkombëtare, e cila e shënoi si pozitive, veprimtarinë e saj. Në të njëjtën kohë, miratimi dhe zbatimi i një Strategjie të re për reformën e selctorit të drejtësisë lca rëndësi thelbësore për të ruajtur dhe përmirësuar efektet/përfitimet e arritura nga proceset dhe aktivitetet e mëparshme të reformës, por gjithashtu për të parandaluar kthimin mbrapa në sektori gjyqësor të shtetit që janë konstatuar gjatë disa viteve të fundit.

Strategjia e re ofron udhëzime, drejtime për të përmirësuar sistemin e drejtësisë duke i tejkaluar mangësitë ekzistuese të karakterit normativ dhe institucional të cilët depërtojnë nëpërmjet saj, por para së gjithash, e ka problemin themelor të ndërhyrjes së qeverisjes ekzekutivitet dhe partiake si shkak për prapambetjes dhe mosfunksionim të sektorit të drejtësisë. Ajo duhet të jetë një udhërrëfyes pas së cilës Qeveria do të ec për të siguruar të gjitha parakushtet brenda juridiksionit të saj për krijimin e një sistemi të pavarur, të paanshëm, efikas, cilësor dhe gjyqësor transparent, i cili do të jetë përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive individuale, si dhe bën mbrojtjen të njëkohshme të interesit publik. Nga ana tjetër, Strategjia përcakton udhëzimet për krijimin e kushteve ligjore por edhe ambient për një realizim të vërtetë të parimit të përgjegjshmërisë nga ana e autoriteteve gjyqësore për punën e tyre. Vitet e fundit, vërehet mungesa të një përgjegjësie të tillë, kryesisht me gjyqësorin dhe zyrën e prokurorit publik. Masat rregullatorë të përcaktuara në Strategjinë, shpesh herë do të thotë "kthim" në legjislacionin para vitit 2009, për shkak se analizat tregojnë se kaosi normativ në drejtësinë penale, administrative, kundërvajtësve dhe drejtës civile fillon mu në atë kohë dhe vazhdon deri në vitin 2017.

Me miratimin dhe zbatimin e strategjisë së re, Qeveria shfaq një angazhim serioz për zbatimin e reformave në gjyqësor, qëllimi kryesor i të cilit është rivendosja e besimit në institucionet, duke siguruar sigurinë ligjore dhe qasjen në drejtësi të paanshme dhe cilësore për qytetarët.

1.2. Objektivat e Strategjisë

Strategjia ka disa qëllime kryesore, të cilat përfaqësojnë unitetin dhe paraqesin tejkalinimin gradual dhe identifikimin e të dobësive në gjyqësor,

vendosjen e saj në rrugën e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe funksionimin e saj stabil si shtyllën kryesore të sundimit të shtetit demokratik juridik.

- Vendosja e parimit të sundimit të ligjit si parimi më i lartë politik dhe ligjor në rregullimin e marrëdhënieve midis tre mbajtësve të pushtetit, duke respektuar pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e pushtetit gjyqësor;

-Largimi nga rendi ligjor i ligjeve që rrezikojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe gjyqtarëve dhe autonominë e prokurorisë publike.

- Heqja dhe lkorrigjimi i rendit juridik të vendimeve ligjore që bllokojnë ushtrimin e funksionit të kontrollit gjyqësor mbi ligjshmërinë e sjelljes së pushtetit ekzekutiv dhe të administratës shtetërore;

-Rivlerësimi i funksionimit të institucioneve të calcuara, në veçanti Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publik, kompetencat kushtetuese dhe ligjore e të cilave janë garanci për sigurimin e pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike;

-De-profesionalizimi dhe përcalcimi i lcritereve dhe procedurave për përgjegjësinë e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë;

-Reforma e gjyqësorit administrativ me qëllim të realizimit efikas të funksionit të tij dhe kontrollit mbi aktet e pushtetit ekzekutiv dhe të administratës shtetërore;

- Forcimi i funksionimit të PSP si një institucion i pavarur brenda PP-së në trajtimin e alcteve të lcompetencës së saj dhe ndjekjes penale të veprave penale të profilit të lartë "krim i bardhë";

-Rivlerësimi i sistemit gjyqësor dhe sistemit të prokurorisë publike nga aspekti i rrjetit dhe kompetencave të institucioneve, ekipimit të tyre kadrovik dhe material;

-Krijimi i paralcushteve financiare, personale, informatike dhe të tjera, rritje urgjente të investimeve buxhetore, me qëllim të rritjes së efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike.

-Rishqyrtim i sistemit të vlerësimit e të kualitetit dhe efikasitetit të veprimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë;

- Thjeshtimi i qasjes në drejtësi nëpërmjet forcimit të ndërmjetësimit, shqyrtimit të ndihmës juridike falas, shpenzimeve gjyqësore, tarifave të avokatëve dhe kostove të tjera;

-Përhapja e funksioneve të sistemit gjyqësor dhe sistemit të informimit të prokurorisë publike;

- Forcimi i sistemit të edukimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve të gjylcatësve, prokurorëve publikë dhe avokatëve

-Forcimi i mekanizmave të transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë përmes sistemit të vetë-rregullimit të shoqatave të tyre profesionale.

- Evropianizimi i gjyqësorit dhe i prokurorisë publike nëpërmjet futjes së standardeve evropiane ligjore, si dhe menaxhimeve dhe standardeve të tjera institucionale dhe procedurale në funksionimin e gjyqësorit, prokurorisë publike dhe avokaturës; përgatitja e gjyqtarëve dhe prokurorëve publike për funksionimin e tyre në zonën e vetme evropiane të drejtësisë dhe zbatimin e vazhdueshëm të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut dhe konventa të tjera ndërlkombëtare për të drejtat e njeriut, harmonizimin e ligjeve materiale dhe procedurale me ligjet e BE-së dhe harmonizimi me ligjet e shteteve anëtare të BE.

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE REFORMES NE DREJTESI

2.1. Pavarësia dhe paanshmëria

Gjendja aktuale:

Republika e Maqedonisë ka miratuar një kornizë ligjore e cila në përgjithësi i përmban standardet ndërkombëtare për një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm dhe për funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë. Edhe përlcundër lcsaj baze normative, ekziston nevoja për të lcryer ndërhyrje ligjore shtesë me anë të së cilës do të zbatohen dhe sigurohet pavarësi dhe paanësi më të madhe në punën e gjyqësorit dhe prokurorisë publike.

Hyrja në gjyqësor dhe në zyrën e prokurorisë publike është një nga çështjet më të rëndësishme. Prandaj është e nevojshme të sigurohen rregulla të reja të rrepta për respektimin e vazhdueshëm të rang listës të përgatitur nga e Akademisë gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve/prokurorëve publik të rinj në Gjylcatat Themelore/Zyrat e Prokurorëve Publikë nga rang lista e renditjes e të diplomuarve të AGJPK². Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve/prokurorëve publik nga ana e Këshillit gjyqësor apo të Këshillit të prokurorëve publik duhet të respektohet rendi lcohor i listave të paraqitura nga ana e Akademisë. Gjithashtu, ekzistimi i drejtës diskretive të Këshillit gjyqësor/ Këshillit të prokurorëve publik me qëllim të mos zgjidhet lcandidat nga lista e të diplomuarve e cila duhet të lcufizohet në lcritere ligjore të sakta dhe për të bërë një vendim të tillë (p.sh.. dokumente të falsifikuara, provimin përfundimtar të falsifikuar, të kushte

² Vlerësimi dhe rekomandimet nga Grupi i Ekspertëve të Lartë të Gjyqësorit për Çështjet e Sistemit të Sundimit të Ligjit 2017, Rekomandime në pjesën për gjyqësorin Kapitulli 1 faqja 11, Bruksel 4 shtator 2017

të përgjithshme ligjore të paplotësuara që të gjendet në listën e të diplomuarve etj.). Në të njëjtën lcohë, vendimi duhet të shpjegohet dhe të shpallet publikisht.³

Edhe pse kornizat kushtetuese dhe ligjore përmbajnë standarde të larta evropiane dhe paraqesin një bazë ligjore për të siguruar funksionimin e duhur të Këshillit gjyqësor, në vitet e fundit, progresi mungon kryesisht për shkak të kritereve të papërcaktuara për anëtarë në KGJRM dhe PSPRM si dhe mundësia për interpretime të ndryshme të termit «jurist i shquar», mungesa e mekanizmave të kontrollit, përgjegjësia dhe llogaridhënia e punës së anëtarëve të Këshillit gjyqësor.

Prandaj, duhet që urgjentisht dhe rrënjësisht të reformohet sistemi gjyqësor, sidomos roli i Këshillit gjyqësor në sigurimin gjyqësorit të pavarur, efektive dhe transparent.

Të gjitha konstatimet e mëparshme të Këshillit gjyqësor referohen edhe për Këshillin e prokurorëve publikë, i cili për publikun e gjerë nuk është mjaftë aktiv dhe bëhet i panjohur në sistemin e autoriteteve gjyqësore.

Gjithashtu, nevojiten dispozita të reja ligjore për përbërjen e organeve për menaxhimin dhe udhëheqje të Akademisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë. Në të ardhmen, krijimi i institucioneve të reja (gjylcatat, komisionet shtetërore) nuk duhet të bëhet duke miratuar ligje në procedurë të shpejtë dhe pa analiza të plota, biseda publike dhe debate (siç ishte rasti me Komisionin e Lustrimit dhe të ashtuquajturit Këshill për përcaktimin e falteve).

Duke marrë parasysh gjendjet e mësipërme, sidomos kur bëhet fjalë për procesin e lustrimit, ligjit për përcaktimin e kushteve për kufizimin e ushtrimit

³REPORT ON THE INDEPENDENCE OF THE JUDICIAL SYSTEM PART I: THE INDEPENDENCE OF JUDGES, adopted by the Venice Commission at its 82nd Plenary Session (Venice, 12-13 March 2010)

të posteve publike, qasje në dokumentet dhe shpalljen e bashkëpunim me organet e sigurisë së shtetit (i njohur si Ligji për lustrim) i cili u hoq në vitin 2015. Megjithatë, sot mbeten pasojat e dëmshme për personat që ishin viktima të këtij ligji. Për të mbrojtur integritetin e tyre personal dhe dinjitetin do të jetë krijuar një bazë ligjore për anulimin e masave të marra ndaj tyre e cila do të shkaktojë fshirjen e Regjistrat ku janë listat me emrat e të ashtuquajturve bashkëpunëtorët të shërbimeve, si dhe anulimin me ligj të të gjitha vendimeve të dhëna këtyre personave.⁴

Në drejtim të parandalimit të paanshmërisë, shmangies dhe abuzimit të sistemit për vendosjen elektronike të lëndëve në gjykata (AKMIS) është e domosdoshme të zbatohen procedurat për shqyrtimin e mënyrave të përdorimit të saj nëpër gjykata në të gjithë territorin e shtetit. Prokuroritë publike që janë të pajisura telncilcisht ende nuk është në funksion sistemi i shpërndarjes elektronike të lëndëve.

Një faktor aktiv në pavarësinë e secilit institucion, këtu bie edhe pavarësia financiare e gjyqësorit. Asociacioni i Gjyqtarëve ka reagime dhe vërejtje serioze në këtë pjesë të pavarësisë gjyqësore për të cilën vazhdimisht propozohen masa për përmirësimin e situatës. Pavarësia e gjyqësorit mund të garantohet, ndër të tjera, me një organizim dhe menaxhim të përmirësuar të burimeve financiare, të personelit, informatave dhe burimeve të tjera për funksionimin efikas të shërbimit gjyqësor dhe stafit të gjykatave. Një rol të madh dhe kryesor në arritjen e këtij qëllimi strategjik i takon edhe Këshillit të buxhetit gjyqësor, i cili në mënyrë që të realizon këtë rol duhet të tregojnë aktivitet të zmadhuar në planifikimin dhe sjelljen e buxhetit gjyqësor para autoriteteve kompetente (prania e Presidentit të SBS gjatë sesioneve tematike në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe në Parlamentin e Republikës së

⁴Ivanovski Abbr.29908 /11

Maqedonisë, dulce dhënë shpjegime dhe argumente për shumën e kërkuar dhe shpërndarjen e buxhetit të gjykatës). Për më tepër, është e nevojshme që SBS në mënyrë të vazhdueshme të përdorë të gjitha mekanizmat ligjore që janë në përputhje me legjislacionin ekzistues me qëllim që të realizoj qëllimin për të cilin është krijuar.

Drejtimit strategjike:

- Vendosja e kriterëve ligjore për (mos) përzgjedhjen e të diplomuarve nga APP nga ana e KGJRM dhe PSPRM. Përcaktimi i një detyrimi ligjor për ICGJRM dhe PSPRM për respektimin e orarit kohor të listave të paraqitura nga Alcademia, në përzgjedhjen e gjyqtarëve / prokurorëve publikë. Shpjegimi i detyrueshëm dhe shpallje publike i përzgjedhjes / mos përzgjedhja së vendimit të kandidatit nga lista. Vendimet e Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit të Prokurorëve Publik për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik duhet të shpjegohen në mënyrë të detajuar dhe të arsyetuar dhe të shpallet publikisht.
- Anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publik duhet të zgjidhen nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik më me përvojë (të cilët së paku përmbushin kushtin për kryerjen e funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit publik në gjykatat e apelit gjegjësisht në prokuroritë e larta)
- Kushti "jurist i shquar" në URM për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publik, me propozim të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë dhe Presidentit të Republikës së Maqedonisë, duhet të përcalctohen me ligj dhe të përfshijnë kriteret për kohëzgjatjen e përvojës në punë, certifikata të fituara, çmime, botime

profesionale dhe shkencore, etj. Këta anëtarë që do të përmbushin kushtet e deklaruar nuk duhet të jenë nga ana e gjykatësve.

- Krijimi i një licornize ligjore për anulimin e masave dhe pasojave ligjore nga procesi i lustrimit.
- Funksionimin i drejtë i sistemit për ndarjen e lëndëve gjyqësore (AKMIS) duke kryer kontroll të rregullt dhe revizion mbi funksionimin e tij me qëllim të parandalimit të çdo lloj abuzimi të sistemit.
- Buxhet gjyqësor që do të jetë i pavarur dhe i qëndrueshëm, në përputhje me përcaktimin ligjor të të ardhurave kombëtare bruto, me pjesëmarrje më të madhe të SBS për realizimin në e këtij drejtimi. Përmirësimi i kushteve për punën e gjyqtarëve, duke siguruar hapësirë të mjaftueshme, pajisje teknike dhe materiale për zyre.

2.2 Cilësia Situata

aktuale:

Në të gjitha analizat e deritanishme të përgatitura nga ana e elcspertëve vendas dhe të huaj, është konstatuar praktika e pabarabartë e gjykatave, e cila paraqet problem dhe rezulton me pasigurinë ligjore të qytetarët. Kur merren vendime për të njëjta ose të baza të ngjashme ligjore, vërehet një gjendje e devijimeve në interpretimin dhe zbatimin e ligjeve nga gjykatat themelore, dhe në veçanti gjykatat e apelit të departamenteve të njëjta ose të ndryshme.

Gjykata Supreme ka kompetencë që të sjell dispozita dhe mendime themelore juridike për zbatimin e vetëm të Kushtetutës, ligjeve dhe rregulloreve të tjera me qëllim që të sigurojë barazinë e personave juridikë përpara ligjit, dulce respektuar licshtu liritë dhe të drejtat e njeriut. Për të harmonizuar praktikën gjyqësore me Gjykatën Supreme, Gjykata Supreme

duhet të përmbushë detyrimin e saj kushtetues duke krijuar pikëpamje parimore dhe mendime parimore ligjore. Është e nevojshme të theksohet se ky rol dhe kompetencat e Gjykatës Supreme në sigurimin e masave të përshtatshme për një uniformitet më të madh të praktikës gjyqësore dhe qartësisë dhe para shikueshmërisë së vendimeve të gjykatave për siguri më të madhe juridilce të qytetarëve në përputhje me standardet evropiane.⁵

Sa i përket vlerësimit të kualitetit të punës dhe procedurës për promovimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, rregullorja ekzistuese nuk ofron kritere objektive dhe përcakton procedurat e sakta dhe precize. Sistemi i vlerësimit duhet të synojë të promovojë cilësinë e vendimeve gjyqësore, lënda, metodat dhe procedurat e vlerësimit duhet të jenë të përcaktuara mirë, të luptueshme dhe të përcaktuara nga gjyqtarët si dhe vlerësimi duhet të jetë transparent.

Këshilli Gjyqësor pa ndonjë argument përkatës vendos dhe shpall se cilat gjyqtarë janë promovuar (të zgjedhur në një gjykatë më të lartë), pa i theksuar arsyet përse ata gjyqtarë konsiderohen më të mirë. Sistemi i vlerësimit është i fokusuar në kriteret kuantitative që duhet të shmangen si një standard i vetëm ose si bazë për vlerësim dhe është e nevojshme të futen kritere cilësore.

Një situatë e ngjashme është konstatuar në fushën e prokurorisë publike në Republikën e Maqedonisë ku janë të nevojshme ndryshime urgjente të sistemit të vlerësimeve mbi parimet identilce me vlerësimin e efikasitetit dhe kualitetit të proceseve gjyqësore dhe vendimmarrëse.

Me ndryshimet e mëhershme ligjore ishin të përshkruara kritere më të ulëta në lidhje me përvojën e nevojshme të punës, përkatësisht vitet e punës ose

⁵ Vlerësimi dhe Rekomandimet nga Grupi i Ekspertëve të Lartë të Gjyqësorit për Çështjet e Sistemit të Sundimit të Ligjit 2017, Referenca Gjyqësore Kapitulli 1 faqja 11, Bruksel 4 shtator 2017

stazhi për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit, Gjykatën Supreme, Administrative dhe të Administrative të lartë, me çka do të ndilcohet në lcuallitetin e vendimeve, e në lçëtë mënyrë sigurohet elcspertizës më të madhe në kryerjen e funksionit gjyqësor.

Provimet profesionale siç janë ato i gjyqësisë, noteri, zbatimi, ndërmjetësimi etj., epen në mënyrë elektronike, gjë që nuk lejon vlerësimin e duhur të cilësive së personave që i japin ato provime. Konkluzioni i përgjithshëm i publilcut është se dhënia e provimit për të hy në profesion juridik, e veçanërisht në sektorin e drejtësisë është e papranueshme dhe mjaft jo adekuate që asnjë kandidat nuk shprehet me gojë për ti treguar njohuritë e tyre dhe të demonstrojnë aftësitë e tyre të të folurit. Gjithashtu, "studimet e rasteve" nga çdo fushë ligjore nuk mund të zgjidhen me anë të një kompjuteri. Në alctet ligjore që përcaktojnë mënyrën e marrjes dhe kryerjes së këtyre provimeve është e nevojshme të sigurohen kritere të larta dhe objektive për vlerësimin e njohurive të kandidatëve.

Profesioni i avokatit në vend është i vetmi profesion në sektorin gjyqësor për të cilin nuk janë paraparë obligime ligjore për trajnim të vazhdueshëm. Një përgjegjësi e tillë ekziston për gjyqtarët dhe prokurorët publilcë, por jo edhe për avolcatët. Është e pamundur të flitet për cilësinë e selctorit të drejtësisë dhe të mos parashikohen obligimet për përmirësimin profesional dhe avancimin e mbajtësve të profesionit ligjor. Organizimi dhe planifilcimi i këtyre trajnimeve duhet të jenë nën juridiksionin e Avolcaturës, meqë zyra e avokatit në KRM është definuar si një shërbim publik i pavarur. Ky vendim për të futur trajnimin e detyrueshëm për avokatët nuk është në kundërshtim me KRM, pasi Kushtetuta i lejon lçëto çështje të

rregullohen me ligj.⁶

Trajnimet tematike për avokatët që janë pjesë e programit të Alcademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë do të vazhdojnë dhe do të organizohen dhe zbatohen në të ardhmen nga ana e Akademisë.

Trajnimet fillestare dhe të vazhdueshme të gjykatësve dhe prokurorëve publikë në APSP duhet të synojnë ruajtjen e lacionit intelektual dhe profesional të gjykatësve dhe prokurorëve publik, mbindërtimin e tyre me njohuri dhe aftësi, mësim të reja e të mësimin e ndryshimeve në legjislacion, si dhe të çdo rregullore të re në sferën e ndjelcjes penale dhe të punës, nxitjen e shkëmbimit ndërkombëtar të përvojave, duke përdorur praktikën e shkrimit ligjor KEDNJ dhe arsyetimit ligjor, etj, me një fjalë, duke parandaluar plakjen e tyre profesionale. Kjo çështje lcerkon precizim të lcritereve dhe kushteve për përbërjen e anëtarëve të menaxhmentit dhe udhëheqjes dhe zgjedhjes së tyre në mënyrë që të përputhen me realitetin shoqëror.

Në mënyrë që të krijohet një mundësi ligjore për futjen e praktikuesve afatgjatë dhe me përvojë në gjykatat më të larta, duhet të përgatitet një analizë gjithëpërfshirëse dhe e plotë e planeve dhe programeve për trajnimin fillestar në kuadër të DPL. Rezultatet e analizës do të jenë bazë për ndryshime të mëtejshme në planet dhe programet, por gjithashtu edhe në legjislacion, në mënyrë që të rritet cilësia e punës së gjyqësorit. Analiza do të përgatitet me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtar.

Për funksionimin më të mirë dhe më efikas të APSP-së, nevojitet plotësimi i stafit dhe përmirësimi i tij telcnilc I cili do të përcillet me sigurimin e kushteve adekuate të hapësirës.

⁶ Neni 53 URM: Avokatia është një shërbim publik i pavarur që ofron ndihmë juridike dhe kryen autorizime publike në përputhje me ligjin.

Është e domosdoshme të forcohet kapaciteti i oficerëve të provës, si dhe të intensifikohen trajnimet në APSP për të gjithë gjyqtarët që punojnë në çështjen penale në drejtim të zbatimit të provës dhe masave të tjera alternative.

Kriteret ekzistuese për gjykatësit porotë nuk janë të përshtatshëm për kryesit e këtij funksioni, gjë që çon në destimulim dhe mungesë të gjyqtarëve të jurisë. Përveç kësaj, shuma e ulët e kompensimit në para lcontribuon në lçetë.

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së përgjithshëm të punës në sektorin e drejtësisë, Ministria e drejtësisë, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë në sektorin gjyqësor me ndihmën e ekspertëve ndërlkombëtarë, do të fillojë hartimin e një plani dhe vlerësimi të menaxhimit të burimeve njerëzore në gjyqësi. Ky dokument do të shërbejë për planifikimin e duhur, cilësor, efikas dhe afatgjatë të zhvillimit në këtë sektor. Gjatë përgatitjes së kësaj analize gjithëpërfshirëse e cila gjatë periudhës së lcaluar nulc ka qenë e përgatitur, kontribut të madh do të japin edhe rekomandimet nga Tvinging projekti IPA 2011 "Përforsimi i qeverisjes së të drejtës" si dhe hulumtimet që udhëhiqen në kuadër të sektorit për resurse njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë. Një analizë dhe hulumtim të llojit të këtillë do të duhet të zbatojnë edhe shërbimet analitike dhe profesionale të të gjitha institucioneve të sektorit gjyqësor.

Drejtimit strategjike:

- Barazimi i praktikës gjyqësore përmes rritjes së trajnimit të gjyqtarëve në kuadër të APSP të analizimit të vendimeve të shpallura gjyqësore.
- Rishikimi i kriterëve të vlerësimit për gjykatësit dhe prokurorët publik duke përdorur praktika dhe përvoja të mira krahasuese. Vlerësimi duhet të bazohet kryesisht në kritere cilësore dhe qëllime objektive të reja dhe të përqendrohet në aftësitë profesionale, integritetin dhe përvojën:

ekspertizën profesionale (njohja e ligjit, aftësia për të zhvilluar procedurat gjyqësore, aftësia për të shlcruar gjylcime të arsyetuara), aftësia personale për t'u marrë me numrin e caktuar të rasteve për veprimin, aftësinë për marrjen e vendimeve, hapje ndaj teknologjive të reja), aftësitë sociale, p.sh. aftësinë për të ndërmjetësuar dhe treguar respekt për partitë si dhe plotësim, posedim të shlcathtësive dhe aftësive udhëheqëse për ata që janë në pozita ku janë të nevojshme **7**

- Përcaktimi i kritereve për promovimin e gjyqtarit dhe prokurorit publik për të marrë parasysht kohëzgjatjen e përvojës gjyqësore / prokurorit të gjyqtarit dhe prokurorit publik, vlerësimin e tij dhe kompletcsitetin e rasteve që ai ose ajo vendos.
- Heqja e provimeve elektronilce dhe paraqitja e provimit me gojë dhe me shkrim të lcandidatëve para komisioneve të elcspertëve, bazuar në lcritere të larta dhe objektive për vlerësimin e njohurive të tyre.
- Futja e një detyrimi ligjor për trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve që do të organizohet nga ana e Odës së avolcatëve me një fond të calctuar ligjor për orë të tëra në baza vjetore.
- Analiza e krijimit eventual të programit të ri për trajnime të veçanta fillestare për pralctilcuesit me përvojë afatgjatë, si dhe për trajnime të vazhdueshme përmes ridefinimit të programeve dhe metodave për kryerjen e trajnimeve.
- Kritere të reja ligjore për përbërjen e organeve drejtuese dhe menaxhimin
- Përmirësimi i kuadrit dhe përmirësimin teknik duke u siguruar kushte adekuate hapësinore.

- Sistemi funksional i provës dhe masa të tjera alternative, duke përmirësuar cilësinë e trajnimit të gjyqtarëve që gjykojnë çështjet penale në fushën e masave alternative dhe provës, kryerjen e trajnimeve për zyrtarët e provës së sapo zgjedhur dhe miratimin e një strategjie të re gjithëpërfshirëse për provën.
- Përcaktimi i kritereve të përzgjedhjes për gjyqtarin porotë dhe ngritja e tarifës për punën e tyre.⁸
- Zhvillimi i resurseve njerëzore në sektorin e drejtësisë përmes zhvillimit të një plani dhe programi.

2.3. Përgjegjësia

Situata aktuale:

Kur bëhet fjalë për përgjegjësinë e organeve gjyqësore, gjegjësisht zbatuesit e veprimtarive dhe funksioneve në këtë fushë, është konstatuar një gjendje e heqjes dorë nga përgjegjësia e të gjithë aktorëve në sistemin gjyqësor në lidhje me kushtet dhe pasojat e pavolitshme nga puna e tyre. Shpesh herë kjo arrihet duke zhvendosur përgjegjësinë nga një institucion në tjetrin dhe duke u fshehur pas interpretimit të ngushtë të kompetencave dhe përgjegjësisë të secilit prej tyre.

Veçanërisht shqetësues është fakti se nuk ka bazë ligjore (as mundësi faktuale) për përgjegjësinë individuale të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë.

Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve rregullohet nga dy ligje të ndryshme, Ligji për Gjykatat dhe Ligji për KGJRM. Ekziston një tendencë për largimin e

⁸ Mk Justice Assessment v.11.2

gjqtarëve në vend të vendosjes së një sanksioni më të butë disiplinor. Disa nga bazat për përgjegjësi disiplinore janë joprecize dhe lca mbi mbulim, gjë që çon në lconfuzion dhe subjektivitet në zhvillimin e procedurës dhe vendosjen e sanksioneve. Po ashtu është vërejtur se nuk ka lidhje direkt midis disa lëndimeve disiplinore dhe gabimeve të gjyqtarit si individ. E gjithë kjo çon në mungesën e ekuilibrit të duhur midis përgjegjësisë dhe pavarësisë së gjyqtarëve.⁹

Përgjegjësia disiplinore e prokurorëve publikë rregullohet me akte nënligjore dhe mungon melcanizmi funksional dhe transparent në lcuptimin e përcaktimit të qartë të bazës për përcalctimin e përgjegjësisë, fillimit dhe vazhdimit të procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore dhe proporcionit të masave disiplinore.

Është e nevojshme të parashilcohen melcanizma të forcuara për monitorim dhe zbulim te rastet e shkeljeve dhe keqpërdorimit të kompetencave zyrtare të policisë dhe jo vetëm nga Ministria e Brendshme, duke krijuar njësi organizative për të monitoruar dhe për të adresuar lcëto kushte brenda zyrës së prokurorit publik dhe Zyrës së Avokatit të popullit. Në këtë kontekst, Zyra e Prokurorit Publik për krim të organizuar dhe korrupsion do të themelon departamenti i cili do të veprojë në këto lëndë, me hetuesit të tyre të veçantë të cilët do të veprojnë vetëm në hetimin e këtyre lcrimeve. Njësi e tillë me kompetenca të njëjta në pjesën e kontrollit civil të policisë do të themelohet në zyrën e Avokatit të Popullit.

Shoqata e gjykatësve në vitin 2014 miratoi një Kod të etikës gjyqësore e cila është plotësisht në përputhje me parimet Bangalore të pavarësisë së gjyqësorit, por në praktikë ende nuk është themeluar organ këshillimor. Është e domosdoshme të vendoset lcrijimi i saj i menjëhershëm në mënyrë që të mund të

⁹ Raporti i Pajtueshmërisë Raundi i Katërt i Vlerësimit GRECO 27 Qershor–1 Korrik 2016

fillohet zbatimi i Kodit të etikës. Paralelisht me zbatimin e Kodit, është gjithashtu e nevojshme të zhvillohen trajnime adekuate për sjelljen etike të gjyqtarëve në përputhje me dispozitat e Kodit të miratuar.

Baza për nxjerrjen e Kodit të etikës për momentin është vërtetuar në standardet evropiane (Parimet Bangalore) por nuk ekziston një detyrim i tillë ligjor në rregullativën vendase.

Drejtime strategjike

- Kriteret ligjore dhe procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë
- Mekanizma funksional dhe transparent për llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, vendosjen e kritereve objektive dhe të matshme për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, pluralizmin e sanksioneve, shkarkimin vetëm për shkelje të rënda dhe të vazhdueshme disiplinore.
- Mekanizma funksional dhe transparent për llogaridhënien e prokurorëve publikë.
- Krijimi i një njësie organizative brenda Prokurorisë Publike dhe zyrës së Avokatit të Popullit për përcjelljen dhe zbulimin e rasteve të tejkallimit dhe shpërdorimit të posteve zyrtare të policisë.
- Ndërtimi i kulturës dhe ndërgjegjes për përgjegjësinë e tyre personale dhe institucionale në punën e gjyqësorit dhe prokurorisë publike.
- Baza ligjore për miratimin e një Kodi të etikës gjyqësore¹⁰. Themelimi i një organi këshillëdhënës në përputhje me Kodin e ri të etikës.

¹⁰ Vërejtjet dhe opinionet e Komisionit të Venecias në dhjetor.

2.4. Efikasiteti

Situata aktuale

Përqindja e rasteve të zgjidhura në shumicën e gjykatave është 100%, që do të thotë se ata janë në gjendje të kontrollojnë fluksin e rasteve të reja gjatë një viti. Për disa vite me radhë, rastet e pazgjidhura gjyqësore nuk kanë qenë një problem i rëndësishëm. Për një numër rastesh të vjetra që ende nuk janë zgjidhur, Këshilli Gjyqësor, në bashkëpunim me kryetarët e gjykatave, ka miratuar një Strategji për zgjidhjen e tyre përmes projektimit dhe propozim masa për tejkalimin e situatës.

Në vitin 2016, buxhetet e gjykatave dhe prokurorëve janë dukshëm më të ulëta se mesatarja evropiane për llojë banori, ndërsa numri i gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor për 100,000 banorë është dukshëm më i lartë se mesatarja evropiane. Edhe pse numri i gjyqtarëve për kokë banori është një kriter i rëndësishëm për matjen e rezultateve të punës së gjykatave, efikasiteti i shërbimit gjyqësor është po ashtu shumë i rëndësishëm. Është shqetësues fakti se vetëm **14.5%** e zyrtarëve gjyqësorë janë bashkëpunëtorë profesionalë. Nuk ka kritere të përshtatshme për përzgjedhjen dhe llogaridhënien e administratorëve të gjykatave. Gjithashtu, parimi i përfaqësimit të barabartë të pjesëtarëve të komuniteteve në Republikën e Maqedonisë, të cilët nuk janë shumicë, veçanërisht ato më të vogla, nuk zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.

Në gjyqësor dhe në zyrën e prokurorit publik, vërehet mungesa e kapaciteteve për planifikim strategjik, menaxhim financiar dhe buxhetor, si dhe kapacitete të pamjaftueshme të shërbimeve të ekspertëve.

Mungesa e praltilcës për zbulimin e plotë të të gjitha gjylcimeve filloi të tejkalohet me vendosjen e plotë të portalit të ri të centralizuar www.sud.mk, i cili mbulon Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe të 34 gjykatat në territorin e Republikës së Maqedonisë. Në këtë mënyrë sigurohet një bazë të dhënash gjyqësore i cili ka një funksion kërkimi.

Sistemi i ekspertizës gjyqësore në masë të madhe ndikon mbi efikasitetin dhe cilësinë e procedurave gjyqësore. Ekzistojnë kritika të shumta për mënyrën aktuale të organizimit dhe funksionimit të këtij sistemi, dhe për këtë shkak do të rishikim rishikimi i saj. Ndryshimet ligjore do të lëvizin në drejtim të braktisjes së rolit të shtetit (Ministria e Drejtësisë) si një faktor në sistemin e ekspertizës gjyqësore, për të siguruar trajtim të barabartë të të gjitha subjekteve të lidhura me ekspertizën e tregut. Ky ndryshim do të pengojë ekzistimin e konkurrencës së pandershme në ekspertizën dhe do të tejkalon problemin e mosrespektimit me parimin e "barazisë së armëve" dhe paanshmërisë të ekspertit.

Drejtimit strategjike:

- Monitorimi i efikasitetit të gjyqësorit përmes treguesve të përcaktuar në Listën e Rezultateve të Drejtësisë të BE-së (lista e rezultateve), CEPEJ dhe standardeve të tjera ndërkombëtare;
- Zbatimi konsulent i Planit të Veprimit për zgjidhjen e çështjeve të vjetra si dhe vëzhgim i rregullt i situatës. Prezantimi i mjeteve të veçanta për identifikimin dhe vënie prioritet të rasteve që mund të çojnë deri në shkelje të parimit të gjykimit brenda një kohe të

- Harmonizimi i numrit të gjyqtarëve në Republikën e Maqedonisë me mesataren evropiane për kokë banori përmes daljeve natyrore të gjyqtarëve;
- Forcimi i kapaciteteve të prokurorisë gjyqësore dhe publike;
- Funkcionalizimi i plotë i bazës së të dhënave të gjykatës (www.sud.mlc);
- Rishikimi i sistemit të ekspertizës gjyqësore përmes ndryshimeve ligjore.

2.5. Transparenca

Një numër i raporteve relevante ndërlcombëtare kanë gjetur punë jo transparente nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publik në lidhje me përmbajtjen e shpjegimeve të vendimeve të tyre. Problemi i zbatimit të vazhdueshëm të parimit të transparencës dhe përfshirjes së publikut në punën e gjyqësorit është mungesa e një sistemi efektiv për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e statistikave mbi punën e gjykatave. Metodologjia për statistikat gjyqësore nuk zbatohet në praktikë sepse softueri për mbledhjen, përpunimin dhe analizën e kostove statistilcore të punës në gjyqësor është jofunlcionale. Kjo situatë mund të tejkalohet përmes përpunimit dhe menaxhimit efikas të sistemit për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistilcore mbi punën e gjykatave dhe prokurorëve publikë nga njësitë e reja organizative të lartpërmendura në kuadër të SSRM dhe SJORM.

Ky sistem, që tani më është i krijuar në KGJRM, duhet të bëhet funlcional përmes krijimit të një njësie të veçantë organizative në KGJRM me kompetenca

më të mëdha për të menaxhuar të dhënat e përmendura të të dhënave, për t'i analizuar ato dhe për të përcaktuar kushtet e vendosura dhe zgjidhjet e propozuara për informimin e rregullt të anëtarëve KGJRM, Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrinë e Drejtësisë. Ky sistem i mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave statistikore mbi punën e prokurorive publike duhet të themelohet brenda një njësie të veçantë organizative të PSPRM. Në të njëjtën kohë, statistikat duhet të jenë në dispozicion për publikut e interesuar. Nivelet e ndryshmeve të qasjes në bazën e të dhënave që do të drejtohen nga njësit të specializuara të cilat duhet të sigurohen nga Enti shtetëror i statistikës, Gjylcata Supreme e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Drejtësisë dhe të gjitha gjykatat më të ulëta në Republikën e Maqedonisë.

Mund të bëhen vërejtje kritike edhe në lidhje me lcanalet e brendshme të pazhvilluara në lidhje me zbatimin e politikës së marrëdhënieve publike dhe komunikimit midis organeve drejtuese në gjyqësor, si dhe mungesës së lcanaleve më formale dhe kapacitetit të zyrës së prokurorisë gjyqësore/ komunale për të komunikuar në mënyrë më efektive me qeverisjen ligjdhënëse dhe me degët tjera të qeverisë lidhur me çështjet më të rëndësishme strategjike dhe operative. Në periudhën e kaluar ishin caktuar persona përgjegjës për marrëdhënie me publikun u emëruan për të gjitha gjylcatat, ndërsa në Gjykatën Themelore Shkup 1 dhe Shkup 2, Gjykata Supreme, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë ishin punësuar persona profesionistë përgjegjës për marrëdhëniet me publikun – zëdhënës. Kjo masë nuk është e mjaftueshme për transparencë të qëndrueshme në punën e gjyqësorit.

Forma e raporteve vjetore të punës së gjylcatave, Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës Supreme janë të pabarabarta, gjë që krijon probleme lidhur me

qartësinë, kuptueshmërinë dhe leximin e raporteve, veçanërisht në pjesën e të dhënave statistikore për shkak të mos sinkronizimit të të dhënave. Vërejtja e njëjtë i referohet edhe për papajtueshmërinë e raporteve mbi punën e prokurorive publike, Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë.

Forcimi i funksionimit transparent të gjyqësorit dhe prokurorisë do të mundësohet edhe nëpërmjet qasjes së publikut në raportet e Ministrisë së Drejtësisë mbi lcontrollet e kryera mbi funksionimin e ACMIS dhe sistemit për shpërndarjen dhe menaxhimin e rasteve në prokurorinë publike dhe raportet mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullores së Punës së Gjykatës.

Drejtime strategjike

- Forcimi i transparencës së Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë.
- Grumbullimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave statistikore mbi punën e gjykatave dhe prokurorive publike në KGJRM dhe PSPRM
- Forcimi i kapaciteteve të marrëdhënieve me publikun.
- Barazimi i formës së raporteve vjetore mbi punën e gjykatave, prokurorëve publikë, KGJRM dhe PSPRM
- Publikimi i raporteve për kryerjen e lcontrolleve të rregullta mbi funksionimin e ACMIS dhe sistemit për shpërndarjen dhe menaxhimin e lëndëve në PP.

2.6. Qasja në drejtësi

2.6.1. Ndhimja juridike pa pagesë

Situata aktuale

Përcaktimi i Republikës së Maqedonisë për t'u bërë anëtare e plotë e BE- së imponon detyrimin për të rregulluar sistemin e ndihmës juridike në përputhje me lcuadrin ligjor dhe standardet e BE-së në këtë sferë.

Ligji për ndihmë juridike falas u miratua në vitin 2009 dhe filloi të zbatohet në vitin 2010, gjatë së cilës u evidentuan tre probleme themelore: 1) qasja e pamjaftueshme për kategoritë më të prekura, përfshirë fëmijët në rrezik (për shkak të zbatimit të dobët); 2) kritere kufizuese për përcaktimin e palëve të kualifikuara që mund të ju ofrohet ndihmë ligjore; 3) shpenzime jashtëzakonisht të larta të paguara ndaj një numri të vogël të avokatëve të regjistruar që ofrojnë ndihmë ligjore. Sistemi ekzistues, përveç juristëve, përbëhet edhe nga më pak se 30 avokatë të vendit dhe juristë të vendosur jashtë, të mbështetur nga 7 organizata të shoqërisë civile në të gjithë vendin, duke mobilizuar lcomunitetin dhe janë të përfshirë në procesin e ndërmjetësimit, dulce ofruar ndihmë juridike falas. Numri i aplikimeve të dorëzuara për BOP mbetet relativisht i ulët. Përqindja e lçerkesave të miratuara për GPL është nën **50%** të lçerkesave të paraqitura. Buxheti i Republikës së Maqedonisë për ndihmë juridilce falas me vite ka qenë 3.000.000 denarë (50.000 euro), që është një nga buxhetet më modeste në Evropë, por kostoja mesatare e ndihmës juridike për çdo rast në Republikën e Maqedonisë është më e larta në Evropë¹⁴. Sistemi për ndihmë

¹⁴ Raporti i Progresit i KE për Republikën e Maqedonisë për vitin 2014 dhe 2015

juridilce në çështjet penale rregullohet me anë të Ligjit për procedurë penale dhe zbatohet nga gjyqësori. Megjithatë, në praktikë, meqenëse gjykatat nuk kanë fonde buxhetore, ato përdorin shpenzimet nga buxheti i përgjithshëm i gjykatës për kontratat dhe shërbime. Gjendja në sistemin e ndihmës juridike falas për vite ka vënë re mungesën e financimit të sistemit të ndihmës juridike falas në një kontekst absolut dhe relativ në lidhje me standardet evropiane lcrahasuese dhe mungesën e qasjes holistike në lidhjen e funksioneve dhe shpërndarjen e roleve tek aktorë të ndryshëm nga jo brenda sektorit të sistemit të ndihmës juridilce.

Drejtimit strategjike:

- Sistemi efektiv, efikas dhe i qëndrueshëm i GPP përmes miratimit të një ligji të ri mbi ndihmën juridike falas:
 - zgjerimin e rrjetit të përdoruesve të GPP;
 - forcimi i kapaciteteve të zyrave rajonale të MD;
 - rritja e numrit të ofruesve të NJF;
 - zgjerimin e fushave të NJF, me përjashtim të sferës penale që do të rregullohet nga LPP;¹²
 - Rregullimi i lcostove të avokatit për NJF;
 - Zgjerimi i shpenzimeve që lidhen me NJF;
 - Mbikëqyrja e cilësisë së punës së NJF;
- Avancimi i financimit të sistemit të ndihmës juridike falas dhe afruar atë me kosto mesatare të EQLE në raport me PBB-në e vendit,
- Bashkëpunimi ndërmjet të gjithë aktorëve në sistemin e NJF
- Rritja e nivelit të informacionit për NJF

¹²IPA 2011 "Forcimi i sundimit të ligjit"

2.6.2. Avokatura

Situata aktuale:

Avokatura si një shërbim publik i pavarur në Republikën e Maqedonisë ekziston në vazhdimësi që nga viti 1945. Ligji ekzistues për Shoqatën e avokatëve u miratua në vitin 2002, por që atëherë është ndryshuar në masë të konsiderueshme nga disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë hequr një pjesë të dispozitave të Ligjit për Odën. Anëtarësia e Shoqatës së avokatëve regjistron më shumë se 2,500 avolcatë aktivë dhe ekziston trendi i anëtarësimit në rritje për rreth 100 avokat në vit, kryesisht për shkak të pamundësisë për të absorbuar avolcatët e rinj në sektorin komercial. Në vitin 2016, tarifat ligjore u ndryshuan dhe çmimet u rritën dukshëm në mënyrë të konsiderueshme në GPL, si dhe u rritën shërbimet noteriale dhe ekzekutimin e detyruar.

Në drejtim të forcimit të profesionit të avokatëve e cila mund t'i përgjigjet sektorit të reformuar të gjyqësisë, nevojitet një analizë gjithëpërfshirëse që do të zbulojë drejtimet themelore për reformën sistematike të profesionit të avokatëve, statutit, pozitës dhe kompetencave të Odës së Avolcatëve.

Drejtimet strategjike:

- Hapje e zyrave ligjore për ofrimin e ndihmës juridilce falas në territorin e secilës gjykatë në Republikën e Maqedonisë nga ana e Odës së avokatëve;

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet MD-së dhe OA në lidhje me përmbajtjen dhe zbatimin praktik të talcsave të avokatëve me qëllim të përmirësimit të qasjes në drejtësi në përputhje me objektivat e kësaj Strategjie.
- Analizë e pozitës ligjore ekzistuese dhe punës së profesionit të avokatëve dhe qasjes së saj në reforma në përputhje me reformat në segmente të tjera të sektorit të drejtësisë.

2.6.3. Përmbarimi

Situata aktuale:

Sistemi i ri i përmbarimit në Republikën e Maqedonisë, që lca hy në fuqi me Ligjin për zbatimin në vitin 2005, ishte zgjidhja më revolucionare në vend, e cila u bë në përputhje me Strategjinë për reformat gjyqësore të vitit 2004, dhe e bëri Republikën e Maqedonisë lider jo vetëm në rajon, por edhe më të gjerë.

Ekzekutuesit funksionojnë që nga viti 2006 dhe vazhdimisht përcjelljet puna e tyre. Është arritur një status i zbatimit të shpejtë ku 50% e rasteve të përfunduara përfundojnë brenda një viti pa asnjë harxhim për shtetin. Janë punësuar më shumë se 500 persona në zyrat e përmbarimit dhe një sasi e madhe e mjeteve (mbi 1 miliardë euro) janë rifutur përsëri në qarkullimin ligjor në vend. Situata e tillë kontribuoi që nga viti 2014, sfera e përmbarimit të mos paraqitet si një fushë problematike në raportet e Komisionit Evropian për vitin 2016.

Miratimi i Ligjit të ri për përmbarim në vitin 2016, zbatimi i të cilit filloi më 01.01.2017 ishte një largim nga koncepti ekzistues dhe shkaktoi reagime të ashpër në sektorin ekonomik të vendit, dhe janë iniciuar procedura para Gjykatës kushtetuese. Kjo gjendje është zbuluar nga raporti i KE-së për

vitin 2016, lcu thuhet se miratimi i nxituar i disa ligjeve, në procedura të shkurtuar pa lconsultim të duhur me elcspertë, shkakton probleme zgjidhja e të cilave kërlcon vullnet të qëndrueshëm politik. Si probleme lcryesore janë zbuluar përfaqësimin i detyrueshëm të kreditorit para ekzekutues nga ana e një avokat në kërkesat për zbatimin e që janë më të larta se 10,000 EUR. përpjekja e detyrueshme për mbledhjen e borxhit jashtë gjyqit për shpenzimet komunale përpara fillimit të procedurës për lëshimin e urdhrin të pagesës noteriale, që është një procedurë jashtëzakonisht komplekse për emërimin e agjentëve përmbarues dhe emërimin e agjentëve të përmbarimit, e cila u tregua si një procedurë joefektive për dhënien e provimit elektronik, si dhe tarifën e tepërt të agjentëve përmbarues¹³.

Drejtimit strategjike:

- Forcimi i kapaciteteve profesionale të lcryerësve, thjeshtimi i ekzelcutimit, zvogëlimi i shpenzimeve të elczekutimit, konceptimi i duhur i provimit për ekzekutuesit dhe mënyra e kalimit të tij.
- Monitorimi i vazhdueshëm i punës të përmbarimit dhe cilësisë së punës së lcryerësve.

¹³ Raporti I KE për avancimin e RM për vitin 2016

2.6.4. Noteriat

Situata aktuale:

Noteri në Republikën e Maqedonisë u fut në vitin 1996 si një shërbim publik i pavarur dhe me autorizime publike e cila bën verifikime të akteve të bazuara në ligj, me kërkesë të qytetarëve, organeve shtetërore, personave juridik dhe institucioneve të tjera të interesuara. Funksionimi i noterit publik ndikoi pozitivisht në funksionimin e përgjithshëm të sistemit ligjor dhe në veçanti ndikoi në nxitjen dhe rritjen e sigurisë juridike.

Në prill të vitit 2016, u miratua një Ligj i ri për noterët, i cili në masë të madhe e prishi konceptin e mëparshëm të noterisë dhe parimet e noterisë latine, gjë e cila gjithashtu u konstatua nga KE në raportin e vitit 2016.

Drejtimit strategjike:

- Forcimi i kapaciteteve profesionale të noterit dhe rritja e efikasitetit të punës së tyre.
- Kthimi i aktit noterial në përputhje me parimet e noterisë latine,
- Përcjellja e rezultateve dhe cilësive të noterit.

2.6.5. Ndërmjetësimi

Situata aktuale:

Ndërmjetësimi në Republikën e Maqedonisë është prezantuar që nga viti 2006, por zbatimi i tij është ende në nivel shumë të ulët. Në vitin 2013, u miratua Ligji i ri për ndërmjetësim. Megjithatë, koncepti jofunksional i ndërmjetësimit mbetet si një vërejtje që ka kaluar vite me radhë në raportin e progresit të Komisionit Evropian.

Ende ekziston mungesa e ndërmjetësve të licencuar para së gjithash për shkak të provimit të ndërlikuar dhe të papërshtatshëm për ndërmjetësuesit.

Po ashtu edhe Bordi i ndërmjetësimit nuk është funksional dhe procesi i themelimit të Odës së Ndërmjetësve të Licencuar gjithashtu është vonuar. Gjyqësori stimulon konceptin e dyfishtë të ndërmjetësimit (ndërmjetësim përpara fillimit të procedurës gjyqësore dhe ndërmjetësimit gjatë vetë procedurës). Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë është pasive për organizimin e trajnimeve në temën e AFP-së, veçanërisht për ndërmjetësim dhe arbitrazh.

Numri i rasteve të paraqitura dhe të regjistruara në regjistrin për evidencën e proceduarave të ndërmjetësimit e cila mbahet nga ana e Ministrisë së Drejtësisë nulc përputhet me numrin e artikulujve të regjistruar në regjistrat ndërmjetësuesve individuale.

Kjo situatë ndodh për shkak të paqartësive në Ligjin lidhur me detyrimin e ndërmjetësuesve për t'i raportuar rastet në MD dhe për interpretimet e ndryshme. Tentimi për ndërmjetësimin edhe pse parashikohet si një mundësi në Ligjin për drejtësi për fëmijët, nuk zbatohet për shkak se Zyra e Prokurorit

Publilc nulc lca burime të mjaftueshme financiare për të respektuar ligjin. Ndërgjegjësimi për përfitimet e ndërmjetësimit mbetet i ulët dhe duhet të punohet për forcimin e mëtejshëm të saj.

Drejtimet strategjike:

- Avancimi i konceptit të ndërmjetësimit përmes ndryshimeve ligjore në pjesën e provimit për ndërmjetësuesit me qëllim që të bëhet revizion për provimin për ndërmjetësuesit, në mënyrë që të marrin në konsideratë kompetencat dhe aftësitë e nevojshme që duhet të lcenë kandidatët; futja e dërgimit të postës elektronilce gjatë ndërmjetësimit, harmonizimi i mbajtjes së regjistrave për procedurat e ndërmjetësimit të kryera nga Ministria e Drejtësisë dhe ndërmjetësit;
- Përdorimi i shpeshtë i ndërmjetësimit nga ana e autoriteteve publilce dulce lehtësuar supozimet dhe duke inkurajuar autoritetet publike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndërsjella përmes ndërmjetësimit;
- Nxitja e përdorimit të ndërmjetësimit në procedurat gjyqësore në zbatimin e Ligjit për drejtësinë e fëmijëve, procedurat gjyqësore kundër gazetarëve për shpifje dhe fyerje, kontestet e konsumatorëve, kontestet e sigurimeve;
- Promovimi i dobive nga ndërmjetësimi për shlcac të ngritjes e vetëdijes në përputhje me Direlctivën e Komisionit Evropian mbi ndërmjetësimin në kontestet civile dhe tregtare të vitit 2008 dhe Direktivën disiplinore të lcontesteve të konsumatorëve;

Drejtime strategjike:

- Avancim i lconceptit të ndërmjetësimit përmes ndryshimeve ligjore në pjesën e provimit për ndërmjetësues me qëllim të rishikimit të provimit për

ndërmjetësues, që të merren parasysh kompetencat dhe aftësitë e nevojshme të cilat duhet t'i posedojnë; implementim i dorëzimit elektronik në ndërmjetësim, harmonizim i udhëheqjes së regjistrave për procedurat e ndërmjetësimit të cilat i drejtojnë Ministria e Drejtësisë dhe ndërmjetësuesit;

- Përdorim i shpeshtë i ndërmjetësimit nga ana e organeve publike përmes mundësisë të pandehjeve dhe nxitjes së organeve publike për zgjidhje të situatave reciproke kontestuese përmes ndërmjetësimit;
- Nxitje e zbatimit të ndërmjetësimit në procedurat gjyqësore gjatë zbatimit të Ligjit për të drejtat e fëmijëve, procedurave kontestimore kundër gazetarëve për fyerje dhe ofendim, kontesteve të konsumatore, kontesteve të sigurimit;
- Promovim i përfitimeve nga ndërmjetësimi me qëllim të përforcimit të vetëdijes, në pajtim me Udhëzimet e Komisionit evropian për ndërmjetësim në lconteste civile dhe tregtare nga viti 2008 dhe Udhëzimi për ndërmjetësim në kontestet konsumatore.

3. PLANIFIKIM STRATEGJIK DHE KRIJIM I POLITIKAVE

Gjendja aktuale:

Përcaktimi i politilcës së zhvillimit dhe reformave të sistemit të gjyqësorit në shtet nuk nënkupton vetëm nismë ligjvënëse dhe ndryshim të legjislacionit ekzistues, por edhe aktivitete tjera të shumta si ndjekje e gjendjes në sferën përkatëse, analiza, ndërmarrje e masave dhe veprimeve lkonkrete.

Ministria e Drejtësisë ka rol kyç në reformën e sektorit të gjyqësorit dhe me ekspertizën e saj në nivel teknik ajo është e kyçur në procesin zhvillimor dhe reformues me pjesën dërmuese të lcapacitetit të saj. Për realizim të përpilctë të kësaj kompetence, nevojitet që në ministri të formohet njësi organizative për

zhvillim strategjik të gjyqësorit, me kompetencë për grumbullimin dhe analizën e të dhënave të ndërlidhura me zbatimin e strategjisë dhe lkoordinimin e njësive përkatëse organizative nga institucionet tjera të gjyqësorit. Kjo njësi organizative nevojitet të posedon funksion të trefishtë: detyra të vazhdueshme për grumbullimin e të dhënave nga njësitë tjera organizative për përgatitjen e raporteve dhe dhënien e nxitjes dhe ndihmës profesionale për zbatimin e qëllimeve të përcaktuara; njësia organizative është promotor i vazhdueshëm dhe mbështetje e tërë procesit; dhe njësia organizative i ofron ndihmë teknike dhe profesionale Këshillit për reforma të sektorit të gjyqësorit.

Këshilli për reforma të sektorit të gjyqësorit paraqet trup këshillëdhënës i Ministrisë të Drejtësisë, i cili me mendimet dhe konsultat e tija profesionale dhe analitike ofron kontribut në krijimin e politikave dhe akteve juridike në lcompetencë të Ministrisë, e të ndërlidhura me reformën e gjyqësorit. Kontribut të tillë Këshilli ofron edhe në përgatitjen e dokumenteve strategjike të Ministrisë.

Për zbatim të suksesshëm të të gjitha udhëzimeve dhe aktiviteteve strategjike të përfshira me këtë dokument, nevojiten ndryshime dhe plotësime të shumta ligjore, si dhe miratim i numrit të caktuara të akteve të reja ligjore. Ministria e Drejtësisë është lcompetente për përgatitjen e legjislacionit të tërë për çka nevojitet angazhim i elcspertëve vendor (të huaj dhe nga shërbimi profesional i Ministrisë) dhe ndihmë profesionale e huaj. Njëkohësisht, personat e angazhuar profesional nevojitet të përgatisin edhe analiza për drejtimin e ndryshimit të legjislacionit. Për lcëtë qëllim, Ministria e Drejtësisë formon grupe pune sipas sferave përkatëse, për çka siguron mjete të caktuara financiare nga buxheti.

Për ndjelcje të implementimit të reformës së sektorit të gjyqësorit, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nevojitet formim i trupit të

udhëhequr nga Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ku do të lcyçen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Financave dhe përfaqësues tjerë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si dhe përfaqësues tjerë të organeve relevante.

Drejtime strategjike:

- Koordinim i reformës në sektorin e gjyqësorit;
- Rol aktiv i Këshillit për reforma të sektorit të gjyqësorit;
- Formim, lcoordinim dhe financim i grupeve të punës për përgatitje të analizave dhe projelcteve ligjore për implementimin e Strategjisë;
- Ndjekje e implementimit të Strategjisë për reforma të sektorit të gjyqësorit përmes indikatorëve të miratuar me Planin aksionar.

4. INSTITUCIONE TË GJYQËSORIT, INSTITUCIONE TJERA NË FUNKSION TË SEKTORIT TË GJYQËSORIT

4.1. INSTITUCIONE TË GJYQËSORIT

Koncepti i organizimit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë i pasqyron standardet minimale të vendosura me më tepër akte juridike ndërkombëtare, duke i ruajtur parimet e shtrirjes, drejtpërdrejtshmërisë dhe funksionalitetit, duke i pasur parasysh edhe parimet procesore që i dedilohen dyanshmërisë së procedurës, gjegjësisht të drejtën e mjetit efektiv juridik dhe qasjen deri në gjyq.

Vendosja aktuale e gjykatave të shkallës së parë dhe raportet vjetore për punë sugjerojnë veprimtari disproporcionale të lëndëve, me lëshime të mëdha të cilat e sugjerojnë nevojën e ndërmarrjes së masave në drejtim të vlerësimit të funksionalitetit të tyre. Rrjedhimisht, të argumentuara janë përpjekjet për

optimizimin e numrit të gjykatave themelore dhe transformimin e tyre në departamente gjyqësore në lcuadër të gjykatave themelore më të afërta me territor.

Numri i gjykatësve në kokë banori në Republikën e Maqedonisë është më i lartë nga mesatarja evropiane, që e imponon nevojën e kryerjes së analizës e cila do të jetë bazë për optimizimin e numrit të gjykatësve, të realizuar në procedurë të përcaktuar me ligj dhe duke i respektuar garancitë kushtetuese për pavarësinë e gjykatësve. Qasja e këtillë do të mundësoj përfitime organizative dhe financiare në aspekt të lcrijimit të paralcushteve më të mira organizative dhe financiare për gjykatësit.

Dispozitat e reja ligjore për Orarin vjetor për punë duhet të mundësojnë vendosjen e profilit të gjykatësit për veprim sipas llojeve të calctuara të lëndëve, me ç'rast kujdesi do të përqendrohet në raportin e ndërlilcueshmërisë së lëndës me përvojën e gjykatësit, më saktë me stazhin gjyqësor të gjykatësit.

4.1.2. Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë

Ligji ekzistues për Këshillin gjyqësor parasheh 8 anëtarë të Këshillit Gjyqësor të cilët zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta nga ana e gjylcatësve, 5 anëtarë nga radhët e juristëve të shquar me propozim të kryetarit të shtetit dhe Kuvendit të RM, kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Ministrit të Drejtësisë. Është konstatuar nevoja për ndryshim të lcushteve dhe kriterëve për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor me qëllim të saktësimin të nocionit "jurist i shquar", siç është më herët e thekuar në një nga udhëzimet strategjike të Strategjisë. Më tutje, nevojitet parashikimi i vendit të kryetarit të Gjykatës Supreme në punën e Këshillit Gjyqësor pa të drejtë vote, në mënyrë analoge me

pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë¹⁴. Gjithashtu, me qëllim të pamundësimit të ndërprerjes së lidhjes mes anëtarit të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjylcatësve dhe "fellës gjyqësore" nevojitet që për anëtarët e Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjykatësve të parashihet bazë ligjore për vazhdim të kryerjes së funksionit primar, gjegjësisht të vazhdojnë të gjykojnë por me volum të zvogëluar të punës (deprofesionalizim i Këshillit Gjyqësor). Zgjidhja e njëjtë është e nevojshme të zbatohet edhe për anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor me përjashtim të kryetarit të tij.

Edhe pse deri tani nga ana e Këshillit Gjyqësor janë bërë disa orvatje për përmirësim të transparencës, sidomos përmes përditësimit të rregullt të internet faqes dhe me mundësim për prezencë të gazetarëve dhe organizatave qytetare në seanca, prapë është lconstatuar mungesë e procedurave të qarta për transparencë dhe qasje në punën e Këshillit. Andaj, nevojitet prezantim publik i gjitha vendimeve që i sjell Këshilli, sidomos për zgjedhje, avancim, vlerësim, përgjegjësi disiplinore, shkarkim të gjykatësve, analiza, konkludime, raporte dhe lajmërimet për gjitha aktivitetet e Këshillit në ueb-portalin.

Në vitin 2015, në drejtim të ndarjes së fazave të procedurës për përgjegjësi disiplinore të gjykatësit (nisje e procedurës, drejtim i hetimit dhe vendosje për përgjegjësinë disiplinore të gjylcatësit), është formuar trup i ri, gjegjësisht Këshill për verifikimin e fakteve dhe inicimin e procedurës disiplinore, me detyrë për të vepruar sipas parashtesave dhe ankimeve kundër gjykatësve në rolin e trupit hetues. Mirëpo, Këshilli i vendosur në këtë mënyrë, si institucion i ri, nuk garanton menaxhim më të mirë me gjyqësorin. Në pajtueshmëri me rekomandimet e Komisionit të Venedikut planifikohet abrogim i plotë i Ligjit për SUF dhe inicim i procedurës disiplinore tek anëtarët e Këshillit Gjyqësor të

¹⁴ Aktgjykim i GJEDN vs. RM, (A. nr. 6899/12); Poposki dhe Duma vs RM, (A. nr. 69916/10 dhe 36531/11), Jashkovski dhe Trifunovski vs RM, (A. nr. 56381/09 dhe 58738/09); Gerovslca – Popçevska vs RM, (A. nr. 48783/07).

lcthehet në fuqi, dulce përcaktuar se anëtarët që e lcanë iniciuar procedurën disiplinore dhe "hetuesit" nuk do të marrin pjesë në vendosjen e lëndës disiplinore si "gjylcatës".

4.1.3. Prokuroria Publike

Në vitin 2010 është miratuar Ligj i ri për procedurë penale, i cili filloi të zbatohet nga dhjetori i vitit 2013. Përmes tij, në mënyrë thelbësore u ndryshuan dhe u rritën autorizimet e prokurorisë publike, sidomos në procedurë paraprake, por edhe gjatë fazave tjera të procedurës penale. Prapë, nuk u miratua Ligj i ri për prokurorinë publike. Nga kjo buron se prokuroria publike funksionon në bazë të dispozitave të paharmonizuara materiale dhe organizative. Përveç kësaj, nuk është kryer as ekipim cilësor i shërbimit të prokurorisë publike.

Mosformimi i qendrave hulumtuese në prokurorinë publike, të cilat duhet të jenë vegla të prokurorit publik në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme në procedurën paraprake dhe të paraqesin mënyrë për institucionalizimin e bashkëpunimit mes prokurorëve dhe policisë, është problem seriozisht i konstatuar.

Ekziston sistem elektronik për menaxhim me lëndët i cili nuk mundëson shpërndarje elektronike me ruajtje të principit të pasigurisë. Për sistemin për menaxhim me lëndët nevojitet zbatim i tij i përpiktë, dhe angazhim e vullnet më të madh nga ana e prokurorëve publike dhe shërbimit të prokurorisë publike, si dhe plotësim i resurseve teknike. Vënia e tij reale në përdorim si dhe implementimi i sistemit elektronik për shpërndarje, do kontribuon drejt institucionalizimit të principit të pavarësisë funksionale (personale, procesore) të prokurorit. Vërehet shkallë e lartë e mospajisjes me kompjuterë, skaner, server, printues, ndërsa rrjetet janë në gjendje veçanërisht kritike.

Është lconstatuar mungesë e lcapaciteteve për planifikim strategjik dhe menaxhim buxhetor e financiar.

Problem të veçantë paraqet vendqëndrimi hapësinor i prokurorive publike me gjykatat. Për këtë qëllim nevojitet krijim i kushteve hapësinore për kryerje të suksesshme të punës së prokurorive.

Sipas raportit të SEREJ ekziston normë më e ulët e lcuadrit joprokuror në kokë prokurori (1,0), krahasuar me mesataren evropiane prej 1,6.

Sistemi për vlerësimin e prokurorisë zhvillohet ashtu që prokurori që është më lartë në shkallën hierarlcilce i vlerëson prokurorët poshtë tij. Kriteret për vlerësimin e prokurorëve publik paraqesin pjesë të akteve nënligjore të Këshillit të Prokurorëve Publik të Republikës së Maqedonisë, ku theksi është vënë mbi parametrat kuantitative, e jo mbi ato lcu qualitative.

Rrjedhimisht, nevojitet ndarje e sistemit për vlerësim individual i prokurorëve nga sistemi për vlerësimin e punës së prokurorisë si institucion, dhe të rregullohet procedura për përcaktimin e cenimit disiplinor dhe e kryerjes joprofessionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të prokurorit publik me Ligjin për prokurori publike.

Për funksionim të drejtë të Prokurorisë Publike nevojitet vendosje e bashlcëpunimit ndërinstitutional operativ dhe sinkronizim me organet e ndjekjes, gjylcatat, entet penitenciare dhe Odën e Avokatëve.

Organizimin e Prokurorisë Publike do ta ndjek sistematizimin organizativ gjyqësor në shtet.

Aktivitetet e pamjaftueshme në hetimet penale të Prokurorisë Publike në tërësi, e në veçanti të PTHP për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit në raste me shenjë të lartë politike, për shkak të përzierjes së bartësve të funksioneve të larta politilce në shtet, lcontribuoi për formimin e prokurorisë së

veçantë – Prokurori publike për ndjekje të veprave penale të ndërlidhura dhe që burojnë nga përmbajtja e ndjelcjes së paligjshme të komunikimeve (PSP).

Për shkak të zgjidhjes ekzistuese ligjore që i përket mandatit për veprim të Prokurorisë publike për ndjekje të veprave penale të ndërlidhura dhe që burojnë nga përmbajtja e ndjelcjes së paligjshme të komunikimeve dhe duke i marrë parasysh numrin dhe kompleksitetin e lëndëve në lcompetencë të kësaj prokurorie, nevojitet krijimi i parakushteve ligjore për vazhdimin e punës së saj. Kjo duhet të realizohet me Ligj të ri për prokurori publike, me të cilin PSP do të transformohet në prokurori të veçantë publike me lcompetenca autonome në lkuadër të sistemit të PP. Me ligjin e njëjtë, saktë do të përcalctohen dhe përkufizohen kompetencat e PSP-së ekzistuese dhe kompetencat e Prokurorisë Themelore Publike për ndjekje të lcrimit të organizuar dhe korrupsionit. Duhet u nisur nga elcipimi lcadrovik dhe teknilc i PSP, juridilcsonin e saj si prokurori e veçantë publike për tërë territorin e RM, me seli në Shkup, në kuadër të PP duhet të zgjerohet edhe me kompetencë për ndjekje të veprave penale me profil të lartë të korrupsionit (white-collar crime), përcalctuar me ligjin e ri për prokurori publike.

Sistemi udhëheqës me prokurorinë publike ende varet nga kompetencat e pakufizuara të Prokurorit Publike të Republikës së Maqedonisë. Nevojitet racionalizim i obligimeve dhe kompetencave në kuadër të sistemit udhëheqës për prokurorinë dhe kompetencat kyçe të prokurorisë publike. Rekomandohet që KPPRM të lctetë rolin primar në përpunimin e politilcave në fushën e udhëheqjes së institucionalizuar dhe menaxhimin e prokurorive publike, ndërsa PPRM të këtë rol primar në përpunimin e politikave të ndërlidhura me zbatimin e së drejtës penale dhe procedurës nga ana e prokurorive publike.

4.1.4. Këshilli i Prokurorëve Publik i Republikës së Maqedonisë

Këshilli i Prokurorëve Publik është veprues pasiv dhe pa ndikim në krijimin dhe zhvillimin e gjitha politikave relevante për veprimtarinë e prokurorisë publike. Roli i tij është tërësisht i padukshëm edhe tek sigurimi i principit të pavarësisë funksionale të prokurorëve nga eprorët e tyre në hierarki. E gjithë kjo e potencon nevojën për rritje dhe përforsim të rolit të Këshillit të Prokurorëve Publik në procesin e planifikimit dhe përgatitjes së zgjidhjeve ligjore përlycatëse nga fusha e procedurës penale, politikës ndëshkuese dhe më e rëndësishmja, telc zbatimi i lirisë prokurore në vendosje.

Kapacitetet për mbështetje administrative të Këshillit të PP duhet lconsiderueshëm të zhvillohen, që të mundet të elcziston siguri se Këshilli i PP do të mundet ta realizon rolin e tij të zgjeruar për planifikim strategjilc, qasjen deri tek profesioni dhe zhvillimi i karrierës, çështjet etike dhe disiplinore, çështjet buxhetore, komunikimi dhe marrëdhëniet me opinionin.

Mungesa e lcapaciteteve për planifikim strategjilc gjithashtu është e ndërlidhur me kapacitetet e pazhvilluara për hulumtim dhe analizë të shërbimeve administrative, të cilat kanë për detyrë sigurimin e shqyrtimit lcrahasues dhe analizave për formulimin e ndryshimeve ligjvënëse në emër të PP.

Përzgjedhja e prokurorëve në prokuroritë themelore publike, të cilën e lcrayen Këshilli i PP, është përshlcruar në mënyrë relativisht të detajuar, por lcriteret dhe procedurat për emërim në prokuroritë më të larta publike nuk janë mjaftueshëm të rregulluara.

Me rregullat ekzistuese sigurohet avancim "vertikal" në prokurori më të lartë, por jo edhe zhvendosje "horizontale" në kuadër të prokurorisë së njëjtë në pajtueshmëri me fushën e specializimit.

Këshilli i PP me Rregullore e rregullon mbilcëqyrjen mbi punën dhe veprimtarinë e PP, por tek ai nuk ka rol aktiv. Mbilcëqyrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë e kryen prokurori më i lartë publik. Nevojitet parashikim i rolit më aktiv i Këshillit të PP gjatë kryerjes së mbikëqyrjes me informim të tij të vazhdueshëm, si dhe dhënie e mundësisë që Këshilli i PP të inicion nismë për kryerjen e mbikëqyrjes.

Kompetenca dhe procedura e Këshillit të PP për mënyrën e veprimit sipas parashtesave nga opinioni kundër prokurorit të caktuar nuk janë rregulluar saktë me ligj. Gjithashtu, nuk ekziston mundësi që anëtarë i Këshillit të PP me nismë personale të inicion procedurë disiplinore kundër një prokurori publik.

Transparenca e Këshillit të prokurorëve publik është në nivel të pakënaqshëm, duke e pasur parasysh se internet faqja nuk përpunohet rregullisht. Është e kufizuar prezenca e gazetarëve dhe sektorit civil në seanca, për ç'arsye nevojitet vendosja e procedura të qarta në pjesën e opinionit, përmes publikimit publik dhe arsyetimit të gjitha vendimeve që i sjell Këshilli, sidomos për zgjedhje, avancim, vlerësim, përgjegjësi disiplinore, shkarlcim, analiza, konkludime, raporte dhe lajmërimë për gjitha aktivitetet e Këshillit në ueb

4.2. ORGANE SHETETËRORE, ENTE, SHOQATA PROFESIONALE DHE ORGANIZATA QYTETARE NË FUNKSION TË SEKTORIT TË GJYQËSORIT

4.2.1. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

4.2.2. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë

4.2.3. Qeveria e Republikës së Maqedonisë

4.2.4. Ministria e Drejtësisë

4.2.5. Avokati i Popullit

4.2.6. Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publik

4.2.7.AMSHA dhe universitetet

4.2.8.Oda e Avolcatëve e Republikës së Maqedonisë

4.2.9.Oda e Noterëve e Republikës së Maqedonisë

4.2.10.Oda e Përmbauesve e Republikës së Maqedonisë

4.2.11. Oda e Ndërmjetësuesve e Republikës së Maqedonisë

4.2.12. Shoqata e Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë

4.2.13. Shoqata e Prokurorëve Publik

4.2.14.Shoqata e Administratës Gjyqësore

4.2.15. Shoqata profesionale

– Shoqata për të Drejtën Penale dhe Kriminologji

5. REFORMA NË SFERA TË VEÇANTA

5.1. Sfera juridiko – ndëshkuese

Ndryshimet dhe plotësimet e shpeshta dhe të shumta të Kodit Penal dhe veçanërisht numri i madh i dispozitave jopenale sollën që të humbet kuptimi për kodifikimin e gjitha veprave penale në Kodin Penal. Këto dukuri shkaktuan probleme në disa nivele, edhe atë: e para, në përshkrimin e veprave penale, duhe u zbrapsur nga principet dhe nomotecnika e përmbajtur në Kodin Penal, dhe e dyta, duke krijuar vështirësi për gjykatësit, prokurorët publik dhe subjektet tjera kompetente gjatë zbatimit të dispozitave me të cilat janë përshkruar veprat penale në ligjet tjera, duke e pasur parasysh konfuzitetin dhe mospërputhjen me Kodin Penal. Njëkohësisht është konstatuar edhe

mospërputhje e dënimeve të përshlcruara në aspelct të peshës së veprave penale, gjegjësisht së mirës së mbrojtur. Vërehet edhe nevoja për harmonizim të sferës ndëshlcuese me udhëzimet më të reja të BE-së.

Në aspekt të gjendjeve të konstatuara imponohet nevoja për miratim të Kodit Penal të ri, i cili përveç përmbajtjes së lartpërmendur mund të kyç dënim plotësues penal – ndalesë për lcryerje të çfarëdo profesioni juridilc, për gjylcatësit e gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër Penale të ndërlidhur me keqpërdorimin e funksionit gjyqësor¹⁵. Një ndalim i tillë duhet të përcaktohet si kusht për zgjedhjen e gjylcatësit edhe me Ligjin për gjylcatat.

Ligji për procedurë penale u miratua në vitin 2010, ndërsa me zbatim filloi nga 1 dhjetori i vitit 2013. Përmes tij u ndryshua sistemi i drejtësisë penale me rol të thelcsuar të prokurorisë publike krahasuar me procedurën paraprallce, u parashikua formimi i qendrave hetuese pranë prolcursorisë publike, u zbatua fazë e veçantë për vlerësimin e aktakuzës, u ndryshua koncepti i diskutimit kryesor, u ridefinua roli procesor dhe autorizimi i gjykatës, palëve dhe mbrojtësit, ndërsa u pranua edhe koncepti i ujdisë për sanlcionin penal, etj.

Është konstatuar edhe keqpërdorim i masës së paraburgimit në procedurat penale për veprat më të lehta penale, përballë trendit të mungesës së plotë të masës së paraburgimit lcure bëhet fjalë për lëndët e ndërlidhura me lccorruption dhe prapavijë politike për ndjelcjen e të cilave është lccompetente Prokuroria Publike për ndjekjen e veprave penale të ndërlidhura dhe që burojnë nga përmbajtja e ndjekjes së kundërligjshme të lccomunikimeve. Paraburgimi lccqpërdoret edhe si masë për detyrimin e të dyshuarit në marrëveshje për pranimin e fajit. Nevojitet saktësim i dispozitave për paraburgim dhe ndërtim të sistemit për praktika të barazuara të gjykatësve dhe prokurorëve publik.

¹⁵ Pilca 29, Vlerësimi dhe rekomandimet nga Grupi i Ekspertëve të Lartë të Gjyqësorit për Çështjet sistematike për sundimin e ligjit 2017, Rekomandime në pjesën për gjyqësorin Kapitulli 1 faqja 11, Bruksel 4 shtator 2017

Me qëllim të ndjelcjes së cilësisë së ndihmës juridike të siguruar nga ana e mbrojtësve sipas detyrës zyrtare, si dhe e mbrojtësve të vendosur nga ana e gjylcatave në rast të mbrojtjes të varfërve dhe të shmangies së favorizimit të avokatëve në dëm të mbrojtjes efektive, nevojitet që në kuadër të Odës së avokatëve të RM të implementohet mekanizëm i pavarur për vlerësimin e cilësisë së mbrojtjes së siguruar.

Veçanërisht shqetëson disfunksionaliteti i qasjes tek mbrojtësi në procedurën penale. Nuk ka procedura dhe mekanizma standarde të detajuara dhe të shkruara që do ta sigurojnë ose lehtësojnë realizimin e së drejtës për mbrojtje të akuzuarit kur është i thirrur në hetim në polici, sidomos nëse është i privuar nga liria, që është vetëm një nga arsyet pse të akuzuarit në Republikën e Maqedonisë thuajse asnjëherë nuk shfrytëzojnë mbrojtës në polici.

Nevoja për tejkalim të interpretimit të pabarabartë për shkak të pasaktësisë së dispozitave të caktuara ligjore dhe zbatimit të tyre praktik, harmonizimi me udhëzimet e reja të BE-së dhe plotësimi i rekomandimeve nga GRETA, janë bazë për ndryshime dhe plotësime të LPP.

Me qëllim të plotësimit të obligimeve ndërkombëtarisht të pranuar të RM-së, e për shkak të kompensimit të viktimave nga veprat penale, nevojitet që ligjërisht të rregullohet formimi i fondit të veçantë shtetëror për kompensimin e viktimave.

Sistemi për mbrojtjen e dëshmitarëve nga viti 2005 sugjeron probleme dhe mospërputhje të shumta në zbatim. Dulce pasur parasysh se Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve zbatohet më tepër se një dekadë, ndërsa në ndërkohë në sistemin penal – juridik u paraqitën ndryshime të mëdha legjislative, u imponua nevoja për rishqyrtim të dispozitave të caktuara të përmbajtura në të. Ministria e Drejtësisë punon në drejtim të adaptimit ndaj probleme të perceptuara në zbatimin praktik, si nga aspekti i masave për mbrojtje,

përforcimit institucional dhe funksionalitetit të organeve të parashikuara me ligjin elczistues (Këshilli për mbrojtje të dëshmitarëve dhe Departamenti për mbrojtjen e dëshmitarëve), ashtu edhe harmonizim të tij me dispozitat tjera nga sfera penale. Gjithashtu, një nga prioritetet në aspekt të këtij ligji është rregullimi i çështjes për mbrojtjen e dëshmitarëve në procedurat për ndjekje të veprave penale të ndërlidhura dhe që burojnë nga përmbajtja e ndjelcjes së kundërligjshme të komunikimeve.

Sistemi për të drejtën e fëmijëve është vendosur me Ligjin për të drejtën e të miturve, i avancuar me Ligjin për të drejtën e fëmijëve, ende ballafaqohet me ekzistim të kushteve të lçeqija materiale, mungesë të shkollimit fillor dhe risocializim sistematik të fëmijëve të privuar nga liria, dhe dërgon në ekzistimin e brengës serioze dhe nevojës për përpjelcje për përforcim shtesë të drejtave të fëmijës. Njëlcohësisht, është lconstatuar mospërputhje me LPP dhe Ligjin për kundërvajtjet, si dhe udhëzimet nga BE. Për shkak të arsyeve të theksuara nevojiten ndryshime në Ligjin për të drejtën e fëmijëve, në drejtim të harmonizimit të tij me ligjet tjera dhe udhëzimet e BE-së, përforcimit të mbrojtjes së fëmijëve viktima të veprave penale, inkorporimit të dispozitave procedurale në aspekt të rrjedhës së shqyrtimit kryesor, lehtësim të qasjes së fëmijëve – viktima deri telc lçëshilla juridike dhe përfaqësim, dhe formim i Fondit për dëmshpërblimin e fëmijëve – vilctima. Ndryshimet duhet t'i përforcojnë edhe mekanizmat për parandalimin e kundërvajtjes fëmijërore në nivel lokal dhe qendror, si dhe përforcimin institucional, material dhe funksional të Këshillit shtetëror për parandalimin e lcundërvajtjes fëmijërore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në materien penale është rregulluar me Ligjin për bashkëpunim ndërkombëtar në materien penale nga viti 2010, i cili filloi me zbatim njëkohësisht me LPP, nga 1 dhjetori i vitit 2013.

Në vitin 2008 u firmos marrëveshja me EUROJUST, ndërsa shteti lca firmosur marrëveshje edhe me EUROPOL dhe është anëtar i INTERPOL, ILECU dhe i SELEC/SEEPAG. Shteti lca emëruar edhe lcontact persona për EJN.

Janë firmosur dhe ratifikuar gjitha instrumentet relevante ndërkombëtare nga sfera e bashkëpunimit ndërkombëtar të gjyqësorit dhe ndihmës juridike ndërlcombëtare, dhe protokollet e tyre plotësuese. Është ratifikuar edhe Protokollin i tretë plotësues ndaj Konventës Evropiane për ekstradim. Njëkohësisht, shteti ka firmosur marrëveshje të shumta bilaterale me shtetet e regjionit dhe më gjerë.

Me qëllim të tejkalimit të problemeve të perceptuara në zbatimin e ligjit në praktikë, sidomos në pjesën e procedurës së shkurtuar për ekstradim dhe dispozitave për përcalctimin e paraburgimit ekstradues, do të nisin ndryshimet e Ligjit për bashkëpunim ndërlcombëtar në materien penale. Nevojitet që të gjithë praktikuesve të involvuar në zbatimin e ligjit t'u mundësohet trajnim i rregullt për shkak të interpretimit dhe zbatimit të drejtë të formave për bashkëpunim ndërlcombëtar.

Në lidhje me rekomandimet e Komisionit të Venedikut, subjekt i ndryshimeve dhe plotësimeve janë Ligji për mbrojtjen e dëftuesve dhe Ligji për mbrojtjen e privatësisë.

Pasi në lcuadër të Ministrisë për drejtësi u miratua Strategjia nacionale për zhvillim të sistemit penitenciar (2015–2019), në këtë pjesë janë përfshirë vetëm çështjet të cilat nuk janë të përmbajtura në Strategjinë nacionale, por edhe disa probleme që burojnë nga zbatimi i saj dhe për tejcalimin e të cilave propozohen zgjidhje konkrete.

Parashikohet miratim i Ligjit të ri për zbatimin e sanksioneve, me të cilin do të kryhet harmonizim i rregullores ligjore nga sfera e zbatimit të

sanlcioneve me qëllimet strategjilce të parashilcuara në Strategjinë nacionale. Në gjykata të caltuara të rritet numri i gjykatësve për zbatimin e sanlcioneve.

Për sigurimin e sistemit efikas penitenciar me qasje profesionale në organizimin dhe monitorimin mbi punën e enteve ndëshkuese – përmirësuese dhe edukuese – përmirësuese, dhe me qëllim të përmirësimit të sferave kyçe të funksionimit të sistemit penitenciar, plotësimin dhe respektimin e standardeve më të larta evropiane për zbatimin e sanksioneve, nevojitet vlerësimi i suksesit gjatë zbatimit në praktikë të Programit të përgjithshëm kognitiv për qasjen lcognitive – bihejvoriste në trajtimin e personave të gjykuar dhe rishilcimin e lcompetencës së drejtorit të Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve, rritje e kompetencave të drejtorëve të institucioneve ndëshkuese – përmirësuese dhe edukuese – përmirësuese, inlcorporim i sistemit efikas për vendosje sipas anlcësave, rasteve të denoncuara për veprim të papërshtatshëm me të burgosurit dhe zbatim i forcës së tepruar, evidentim përkatës dhe vlerësim i rasteve.

Në pjesën për probacion nevojitet ekipim i tërë shërbimit për probacion me kuadër profesional përkatës në tërë territorin e shtetit. Gjithashtu nevojitet miratim i akteve nënligjore të cilat burojnë nga ligji.

5.2. Sfera administrativo – juridike

Kontesti administrativ si mbrojtje gjyqësore e të drejtave të qytetarëve nga alctet joligjore dhe punën e administratës në Republikën e Maqedonisë ka traditë të gjatë. Për herë të parë është implementuar me Ligjin për konteste administrative në vitin 1952, i plotësuar me Ligj të ri për kontestet administrative në vitin 1977 dhe me Ligjin e fundit të tretë për kontestet administrative të miratuar në vitin 2006, me të cilin në shtet u formua gjyqësor

i veçantë dhe i specializuar administrativ. Ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2010 me dispozita për formimin e Gjykatës së lartë administrative, pa u përshkruar dispozitat për udhëheqjen e procedurës para kësaj gjykate.

Problemet më të mëdha me të cilat qytetarët ballafaqohen në marrëdhëniet administrativo – juridike me shtetin (me organet publike në pajtueshmëri me terminologjinë e LPPA) janë:

- e para, kohëzgjatja e tërë procedurës administrative (procedurë administrative para organeve publike, pas së cilës vijon kontesti administrativ) dhe
- e dyta, moszbatimi i vendimeve të miratuara nga ana e gjyqësorit administrativ.

Kohëzgjatja e procedurës e cila përbëhet nga pesë instanca, edhe atë dy para organeve të administratës shtetërore të quajtura organe publike dhe tre në kuadër të kontestit administrativ para Gjykatës administrative, Gjykatës së Lartë Administrative dhe deklarativisht para Gjykatës Supreme të RM, e bëjnë mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të vonshme dhe të shtrenjtë.

Nga hulumtimet e komunitetit akademik dhe organizatave joqeveritare, si dhe nga raportet e përpiluara nga ekspertët në kuadër të projektit*¹⁶ IPA 2007 lconstatohet siç vijon: stërzgjetet mbrojtja e të drejtave të qytetarëve, vërtetohen alctgjykimet e njëjta të Gjykatës Administrative të cilat paraprakisht kanë qenë të abroguara dhe të kthyer në vendosje të përsëritur, që për palën e kishte lcuptimin e humbjes së lcohës dhe rritjes së shpenzimeve.

Është lconstatuar kotësi nga falcti që organet publike në lcontestin administrativ që udhëhiqet kundër tyre të përfaqësohen nga avokatura e

¹⁶ "Ndërtim i kapaciteteve të gjyqësorit administrativ në Republikën e Maqedonisë përballë sfidave për arritje të standardeve evropiane" – Universiteti "Shën Qirili dhe Metodij" Shlcup, 2015; dhe Projekti IPA 2007 "Mbështetje për veprim dhe funksionim më efikas, efektiv dhe bashkëkohor të Gjykatës administrative" Anelcsi 6, dhjetor 2011

shtetit. Gjegjësisht, në pajtim me LPPA nga viti 2015, nëpunësi që e lca udhëhequr procedurën administrative është i obliguar të njëjtën edhe ta mbaron, ose me fjalë tjera, ta sjell dhe firmos aktvendimin. Ai përgjigjet në ankesën kundër aktvendimit të tij para komisionit shtetëror të shkallës së dytë që vendos sipas ankesave në procedurën administrative. Nëse qytetari në cilësi të palës lca iniciuar lcontest administrativ kundër aktvendimit të shkallës së dytë, nuk ekziston asnjë arsyetim logjik ose juridik që avokati i shtetit ta përfaqëson organin publik në kontestin e tillë administrativ.

Mosvendosja në jurisdiksion të plotë nga ana e gjylcatësve të Gjylcatës Administrative paraqet problem shtesë për qytetarët që lcrijon ping-pong efekt në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Nga njëra anë, ata kanë fituar aktgjykim në favor të tyre nga Gjykata Administrative, por nga ana tjetër në vend se ajo ta zgjidh problemin në mënyrë meritore, i kthen në udhëheqje të sërishme të procedurës administrative para organeve shtetërore. Në këtë mënyrë, qytetarët kanë përfituar drejtësi gjyqësore de jure ose në letër, por jo edhe de facto ose realisht. Ky problem është pasojë e mungesës së alcteve nga ana e organeve të paditura të administratës shtetërore gjatë kontestit administrativ, për ç'arsye Gjykata Administrative nuk mund të vendos në mënyrë meritore në kontest të jurisdilcsionit të plotë.

Aktgjylcimet me të cilat Gjylcata Administrative i abrogon aktvendimet e organeve të administratës shtetërore dhe i kthen në vendosje të sërishme me udhëzimet konkrete gjyqësore, nulc zbatohen nga ana e organeve të administratës shtetërore të cilat sërish sjellin alctvendim me përmbajtjen e njëjtë sikur aktvendimi më parë i abroguar. Gjykata Administrative ballafaqohet me problem të moszbatimit të aktgjykimeve të tij, dukuri e cila nuk vërehet në asnjë shtet ku zbatohet në mënyrë konsekuente parimi i sundimit të së drejtës.

Kontestet nga marrëveshjet administrative, edhe pse janë salctë të përcaktuara me LKA nga viti 2006, ndërsa nga viti 2015 edhe me LPPA si lcompetencë e Gjykatës Administrative, ende në numër më të madh zgjidhen para gjykatave të rregullta dhe në këtë fushë ekziston pabarazi e plotë në zbatimin e së drejtës.

Kushtet për punë të Gjykatës Administrative (hapësinore, teknilce dhe kadrovike) janë të reduktuara në minimum dhe aspak nuk korrespondojnë për gjykatë të këtij rangu, që ballafaqohet me kontestet më të rëndësishme kundër shtetit.

Për shkak të gjitha rrethanave negative të lconstatuara më lartë, nevojitet përpilim i analizës gjithëpërfshirëse për gjendjen në gjyqësorin administrative, rezultatet e së cilës duhet të jenë bazë për ndryshimet e ardhme ligjore në këtë materie.

Avokatura shtetërore nuk ka nevojë t'i përfaqëson organet publike në kontestet administrative, duke i marrë parasysh vendimet e reja në LPPA sipas të cilave personi zyrtar që e udhëheq procedurën e sjell edhe alctin final. Rrjedhimisht, personi zyrtar duke e përfaqësuar organin publik do t'i mbron vendimet e tij në kontest administrativ.

Nevojitet ndërmarrja e masave për zbatim të përpilctë të obligueshmërisë së alctgjykimeve gjyqësore dhe të parashikohet mënyra për të përcaktuar sa nga aktgjykimet e plotfuqishme janë zbatuar në afatin e parashikuar ligjor prej 30 ditëve. Kjo është një nga principet evropiane të theksuara në Protokollin.

Në LKA duhet të përmbahen dispozita për sanksionimin e organeve publike të cilat Gjykatës Administrative nuk do t'i dorëzojnë aktet e nevojshme për udhëheqje dhe përmbyllje të drejtë të lcontestit administrativ.

Nevojiten trajnime specifike të gjylcatësve administrativ për gjylcim të drejtë të kontesteve nga marrëveshjet administrative, të cilat do të realizohen nga elcspertë vendor dhe të huaj.

Numri i gjykimeve me shqyrtim të mbajtur publik nevojitet të rritet.

LKA duhet të harmonizohet me LPPA nga viti 2015.

Ekziston nevojë për plotësimin dhe saktësimin e të dhënave të caktuara në kuadër të Raporteve vjetore për punën e Gjykatës Administrative, si për shembull sa vendime janë sjellë në kontest të juridiksionit të plotë, sa vendime janë sjellë pas shqyrtimit të mbajtur gojor, sa nga vendimet i ka sjell gjykatës individ, gjegjësisht të saktësohet baza e vendimeve të pranuar.

Është i domosdoshëm përmirësimi i kushteve hapësinore dhe teknike për punë të Gjylcatës Administrative, që të munden gjylcatësit administrativ në mënyrë më efikase ta lcryejnë punën e tyre, por edhe të përfitojnë dinjitetin dhe integritetin e nevojshëm.

5.3. Sfera kundërvajtëse – juridike

Sfera kundërvajtëse – juridike në RM përjetoi ndryshime të shumta në periudhën e lcaluar, po ajo ende ngelet jofunlcionale dhe e lcontestuar.

Sistemi juridik maqedonas njih dy kategori të veprave ndëshlcuese: vepra penale dhe kundërvajtje. Veprat penale janë të rregulluara me Kodin Penal, ndërsa kundërvajtjet me Ligjin për lcundërvajtje. Me Ligjin për gjykatat nga viti 1995 u abroguan gjylcatat e mëparshme për lcundërvajtje dhe u krijua organizim i vetëm gjyqësor. Para sjelljes së këtij ligji për kategorinë më të lehtë të veprave ndëshkuese – kundërvajtjet, kompetencë për shqiptimin e sanksioneve kishin gjylcatat për kundërvajtje, por edhe organet e administratës shtetërore dhe

shërbimet publike të cilave me ligj u jepeshin autorizime për shqiptimin e sanksioneve të tilla.

Me vendim të Gjylcatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë nga viti 1996 u abrogua dispozita nga Ligji për gjykatat, me të cilën ishte e rregulluar se për lloje të caktuara të kundërvajtjeve mund të vendosin lloje tjera të organeve (doganore, devizore, të tregtisë së jashtme dhe tatimore). Vendimi i këtillë ishte rezultat i interpretimit të Gjylcatës kushtetuese se për gjitha veprat penale sipas Kushtetutës mund të vendosin vetëm gjykatat. Si pasojë e këtij vendimi, numri i lëndëve kundërvajtëse para gjylcatave themelore të cilat shënonin rënie të vazhdueshme, u rrit në mënyrë enorme. Për shkak të moszgjidhjes në kohë të lëndëve kundërvajtëse, pjesa dërmuese e tyre pësonin parashkrim, që e vinte në pikëpyetje dobinë e udhëheqjes së procedurës. Nga ana tjetër, organet e administratës shtetërore, të cilave u morrën autorizimet për udhëheqje të procedurës kundërvajtëse dhe shqiptim të sanksioneve, u gjendën në pozitë pasive, pa mundësi për veprim efikas në zbatimin e autorizimeve të tyre mbilcëqyrëse.

Me shpalljen e amendamenteve për ndryshim të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë në dhjetor të vitit 2005, më saktë me amendamentin XX u krijuar mundësi që në raste të caktuara me ligj, për kundërvajtje, sanksion të mund të shqipton organ i administratës shtetërore, ose organ tjetër që kryen autorizime publike, vendimi final i të cilit do t'i nënshtrohet mbrojtjes gjyqësore nën kushte dhe procedurë të përcaktuara me ligj. Kjo dispozitë kushtetuese juridilcisht u operacionalizua me sjelljen e Ligjit për kundërvajtje në maj të vitit 2006. Ajo që përfaqëson mangësinë më të madhe të këtij Ligji për kundërvajtje është ndërlikueshmëria e tij nomoteknike, sepse në tekst të njëjtë ligjor sistematizohen dy lloje tërësisht të ndryshme të kundërvajtjeve si vepra të

ndëshlcueshme dhe dy procedura tërësisht të ndryshme të procedurave juridike para bartësve të ndryshëm të pushtetit shtetëror – gjyqësor dhe administratë.

Njëlcöhësisht, Ligji përmbante edhe dispozitë sipas së cilës me dispozitat e veçanta materiale mund të përshkruhen gjoba për kundërvajtje jashtë kornizave të përcaktuara me Ligjin për kundërvajtje si dispozitë e përgjithshme dhe ligj sistematik. Kjo mundësi ligjore u shfrytëzua ashtu që me numër enorm të ligjeve materiale, organet e administratës shtetërore parashikuan në kompetencë dhe të drejtë të tyre të shqiptojnë gjoba prej disa mijë (ndonjëherë edhe dhjetëra mijë) euro në lcundërvlerë denari.

Zgjidhja e lcëtille ligjore pësonte lcritilca të shumta nga komuniteti i biznesit si më i dëmtuar, nga opinioni shkencor dhe profesional që kërkonte ndryshime urgjente të lcësaj dispozite e cila mundësoi dy çrregullime serioze të rendit juridik në shtet: e para, përshlcrim i gjobave për lcundërvajtje më të larta nga dënimet për veprat penale të përcaktuara në KP, dhe e dyta, mosrespektim i parimit 'non bis in idem', sepse pësoi shpeshtim i rasteve kur një person paraqitet si i akuzuar, i gjykuar dhe i dënuar edhe në procedurë lcundërvajtëse, edhe në procedurë penale, për vepër të njëjtë e cila është përshkruar si kundërvajtje në ndonjë dispozitë materiale, dhe njëkohësisht edhe si vepër penale në KP.

Ligji i ri për kundërvajtje u miratua në vitin 2015 dhe në pjesën dërmuese është identik me Ligjin e mëparshëm për kundërvajtje nga viti 2006, me ç'rast u lcryen ndryshime të caktuara nomotelcnilce dhe i ndryshua numeracioni i dispozitave të caktuara.

Ndryshimi më i pritur në aspekt të zvogëlimit të gjobave që mund t'i shqiptojnë organet kundërvajtëse jo vetëm që nuk është përmbajtur në Ligjin e fundit për lcundërvajtje, por për lcundrazi, gjobat ngelin të pandryshuara, në vende madje edhe të zmadhuara, dhe ende ngelet prezentë dispozita e cila

parasheh mundësinë "përjashtimi të ngelet rregull". Në fakt, lçjo do të thotë se ekziston mundësia me dispozita të veçanta materiale të parashikohen gjoba më të mëdha se gjobat e përcaktuara me Ligjin për lçundërvajtje.

Risi tjetër e rëndësishme është inkorporimi i dyshkallësisë në procedurën kundërvajtëse në kuadër të administratës shtetërore. Kështu, pala së cilës organ lçundërvajtës i lca shqiptuar sanksion lçundërvajtës, lca të drejtë të ankesës para Komisionit Shtetëror për Vendosje në Shkallë të Dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse, e themeluar me Ligj të veçantë për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendosje në Shkallë të Dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse. Kjo përvojë ligjvënëse paraqet kuriozitet të veçantë, sepse deri tani nuk është vërejtur rast ku miratohet një ligj për themelimin e një organi shtetëror, ndërsa në ligj tjetër të përshkruhen autorizimet e organit të ri (LK), ndërsa në ligj të tretë (LPPA) të përshkruhen rregullat për vendosje të atij organi.

Për punën e Komisionit të posaçformuar shtetëror nuk ka asnjë të dhënë, edhe pse ekziston dy vite. Kompetenca e tij e gjerë të vendos si organ i shkallës së dytë për gjitha procedura kundërvajtëse dhe inspektuese me siguri ishte arsye për përcaktimin e pagave jashtëzakonisht të larta për anëtarët e tij, dhe prandaj habit falcti se mungojnë analiza për punën e Komisionit, strategjia apo programi për punën e ardhme, të dhëna statistilcore për efikasitetin, cilësinë dhe transparencën e tij. Internet-faqja zyrtare e Komisionit nuk përmban asnjë të dhënë relevante për analizë. Dulce e marrë parasysh faktin se u sigurua mbrojtje e rregullt juridike lçundër alctvendimeve për lçundërvajtje, të miratuara nga organe të administratës shtetërore me Ligjin e vjetër për kundërvajtje përmes së drejtës për padi për inicim të kontestit administrativ, si dhe ajo që procedurat inspektuese janë vetëm lloj i procedurave administrative për të cilat tashmë

ekziston organ shtetëror i shpallës së dytë, parashtrahet pyetja për arsyet dhe motivet për formimin e këtij Komisioni.

Zgjidhjet e lçetilla në Ligjin e ri për kundërvajtje, të cilat mundësojnë që organe të administratës për shqiptojnë gjoba në shuma milionëshe dhe mbrojtje gjyqësore e cila nuk e anulon zbatimin e tyre që realizohet nga ana e DAP në procedurë tatimore, as për së afërmi nuk lcorrespondon me nocionin kundërvajtje të përcaktuar si "jo e drejtë më e vogël nga veprë e kryer penale". Për jo të drejtë më të vogël pason procedurë më e thjeshtë dhe sanksione më të vogla, që është tërësisht në kundërshtim me përcaktimin e Ligjit ekzistues për lçundërvajtje. Nëse nisemi nga falcti se diferenca mes lçundërvajtjeve dhe veprave penale është vetëm kuantitative (jo e drejtë më e vogël përballë më të madhes), atëherë ngelet e hapur çështja pse niveli i gjobave të përcaktuara në LK dhe KP është në proporcion të lçundërt me nivelin e jo të drejtës. Zgjidhjet e këtilla ligjore janë të padrejta dhe të paarsyeshme.

Niveli i gjobave, si dhe rregullat për mbrojtje juridike të qytetarëve nga aktvendime eventuale joligjore për lçundërvajtje të përshlçruara me LK, e sjellin në pikëpyetje zbatimin e përpiktë të parimeve të sundimit të së drejtës, sigurisë juridike, barazisë dhe proporcionalitetit.

Vërehet elçzistimi i inflacionit nga lçundërvajtjet në lçompetencë të organeve lçundërvajtëse jogjyqësore, si dhe numër tepër i madh i ligjeve me të cilat përcaktohen këto kundërvajtje dhe niveli i gjobave për kryerjen e tyre.

Nga e gjithë lçjo, nevojitet analizë gjithëpërfshirëse e përmbajtjes dhe implementimit të kornizës ligjore për kundërvajtjet, e cila do të sugjeron mënyrat dhe kriteret për përkufizimin e nocioneve kundërvajtje gjyqësore dhe delikt administrativ.

Hapësira e nivelit të gjobave duhet të përcaktohet me ligj dhe të kufizohet mundësia për mënjanim nga ai me ligjet e veçanta materiale.

Ndjehet nevoja për rishilcimin e sanksioneve kundërvajtëse me atë që, mes tjerash, do të inlcorporohet vërejtja si një lloj sanksioni për personat juridilc. Mundësia për shqiptimin e vërejtjes për personat fizilc duhet të stimulohet sepse, edhe pse e njëjta parashikohet me LK, në praktikë shqiptohet rrallë.

5.4. Sfera civile – juridike

Reforma gjithëpërfshirëse e sistemit civil – juridik në Republikën e Maqedonisë filloi në vitin 2011 me nisjen e kodifikimit të së drejtës civile, me qëllim të përmirësimit të cilësisë në rregullimin e së drejtës civile dhe tejkalimit të atyre zbrazëtirave juridike me të cilat për momentin ballafaqohen pralctilcantët juridilc gjatë zbatimit të normave civile – juridike. Reforma është planifilcuar të realizohet në katër sfera civile – juridilce, edhe atë: marrëdhëniet sendore – juridike, marrëdhëniet obligative, marrëdhëniet trashëguese – juridike dhe marrëdhëniet familjare – juridike. Rregullimi i të tre sferave nga fusha juridike civile është në fazë të avancuar të përgatitjes dhe të njëjtat janë harmonizuar me legjislacionin më të ri evropian që i mbulon këto sfera, si dhe trendet e sistemeve bashkëkohore juridike. Duke e pasur parasysh zbatimin shumëvjeçar të Ligjin për pronën dhe të drejtat tjera sendore të miratuar në vitin 2011 dhe nevojën për harmonizimin e tij për aktet tjera që i mbulojnë marrëdhëniet sendore – juridike, planifikohet përgatitja e Ligjit të ri për pronën dhe të drejtat tjera sendore. Pasi të vlerësohet se është vendosur sistem i normave funksionale civile – juridilce, do të qaset drejt lcodifilcimit të materies së tërësishme civile – juridike.

Shumat e larta për dëmshpërblim nga fyerja dhe shpifja kundër gazetarëve dhe bartësve të funksioneve publike do të reduktohen në shuma simbolike.

Në pjesën e ligjeve procesore, reforma u bë me sjelljen e Ligjit të ri për procedurë lcontestimore (LPK) në vitin 2005 dhe ndryshimet nga viti 2010 dhe 2015. LPK lcontribuoi për shkurtimin e lcohëzgjatjes së procedurës dhe zvogëlimin e mbingarkimit të gjykatave me përjashtim nga kompetenca gjyqësore të urdhëresave të paguara dhe procedurave trashëguese të cilat me vite e ngarlonin sistemin gjyqësor. Mirëpo, zbatimi pralctik i pjesës nga dispozitat e reja, sidomos ato që i dedikohen pyetësorit të kryqëzuar, ekspertizës së obliguar me parashtrim të vetë ankesës, etj. e shfaqin nevojën për rishqyrtimin e lcëtyre dispozitave me organizim të dislcutimeve dhe debateve publilce, me përfshirje të opinionit më të gjerë shkencor dhe profesional.

Ligji për ekspertizë u miratua në vitin 2009. Prapë, për shkak të probleme të perceptuara në zbatimin e normave të caktuara nga zgjidhja alctuale ligjore, sidomos në pjesën e hyrjes në profesionin e elcspertit përmes dhënies së provimit në testimin elektronik për ekspertë, dhe mënyrën e krijimit të provimdhënies elektronike, konsiderueshëm u vështirësua futja në profesion, për ç'arsye do të niset me përgatitjen e ndryshimeve të zgjidhjes elczistuese ligjore.

6. KORNIZA JURIDIKE E SEKTORIT TË GJYQËSORIT

6.1. Korniza normative

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare nr. 52/1991, 91/2001, 84/2003,107/2005, 3/2009 dhe 49/2011); 31/199
- Ligji për gjykatat („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2006,35/2008 dhe 150/2010); 8,

- Ligji për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/2006, 69/2006,150/2010,100/2011, 20/2015 dhe 61/2015);
- Ligji për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.20/2015,192/2015 dhe 231/2015);
- Ligji për zbatimin e vendimeve të GJEDN („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.67/2009 dhe 43/2014);
- Ligji për buxhetin gjyqësor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/2003; 37/2006; 103/2008 dhe 145/2010);
- Ligji për pagat e gjykatësve („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.110/2007, 103/2008; 161/2008; 153/2009; 67/2010; 97/2010; 135/2011 dhe 231/2015);
- Ligji për shërbimin gjyqësor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/2014, 33/2015, 98/2015 dhe 6/2016);
- Ligji për menaxhim me lëvizjen e gjësëndeve në gjykata („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 171/2010);
- Ligji për prokurori publike („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.150/2007 dhe 111/2008);
- Ligji për Këshillin e prokurorëve publik („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.150/2007 dhe 100/2011);
- Ligji për pagat e prokurorëve publik („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 153/2009; 67/2010; 97/2010 dhe 231/2015);
- Ligji për shërbimin e prokurorisë publike („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2015, 231/2015 dhe 11/2016);
- Ligji për prokurorinë publike për ndjekjen e veprave Penale të ndërlidhura dhe që burojnë nga ndjelcja e kundërligjshme e komunikimeve („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 159/2015);

- Ligji për ndihmë juridilce falas („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 161/2009,185/2011, 27/2014 dhe 104/2015);
- Ligji për avokaturë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 59/2002, 60/2006, 29/2007,106/2008,135/2011,113/2012 dhe 148/2015);
- Ligji për noteri („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/2016 dhe 142/2016);
- Ligji për përmbarim („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/2016 dhe 142/2016);
- Ligji për ndërmjetësim („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 188/2013,148/2015,192/2015 dhe 55/2016);
- Kodi Penal („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002,43/2003,19/2004, 81/2005,60/2006,73/2006,7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011,135/2011,185/2011,142/2012,166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014,115/2014,132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015 dhe 226/2015);
- Ligji për procedurë Penale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2010,100/2012 dhe 142/2016);
- Ligji për drejtësinë e fëmijëve („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 148/2013);
- Ligji për zbatimin e sanksioneve („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 2/2006, 57/2010, 170/2013, 43/2014, 166/2014, 33/2015, 98/2015 dhe 11/2016);
- Ligji për bashkëpunim ndërlcombëtar në materien Penale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/2010);
- Ligji për probacion („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 226/2015);

- Ligji për kundërvajtjet („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2015);
- Ligji për kontestet administrative („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2006 dhe 150/2010);
- Ligji për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/2015);
- Ligji për procedurë kontestimore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/2005,110/2008, 83/2009,116/2010 dhe 124/2015);
- Ligji për marrëdhëniet obligative („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/2001, 4/2002, 5/2003, 84/2008, 81/2009, 161/2009 dhe 123/2013);
- Ligji për pronë dhe të drejta tjera pronësore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/2001; 92/2008; 139/2009 dhe 35/2010);
- Ligji për trashëgimi („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.47/1996);
- Ligji për provimin e gjyqësorit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.137/2013 dhe 153/2015), dhe
- Ligji për përgjegjësinë civile për fyerje dhe ofendim („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 143/2012)

6.2. Dokumente tjera relevante:

- Strategjia për reforma të sistemit të gjyqësorit 2004–2007 me Plan i Veprimit;
- Strategjia për teknologji informatike – komunikuese në jurisprudencë 2007– 2010;
- Strategjia për reforma të së drejtës ndëshkuese 2007–2010;
- Strategjia nacionale për zhvillim të sistemit penitenciar 2015–2019;

- Strategjia për zhvillim të shërbimit të probacionit në RM 2013–2016;
- Plani strategjik i Ministrisë për drejtësi;
- Programi nacional për miratimin e të drejtës së BE-së 2017–2019;
- Programi shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe parandalimin dhe zvogëlimin e përplasjes së interesave me Planin e Veprimit 2016–2019; dhe
- Propozim i organizatave qytetare për reforma urgjente demokratike, korrik 2017.

6.3. Raporte ndërkombëtare për Republikën e Maqedonisë:

- Raporti vjetor i përparimit të Republikës së Maqedonisë i Komisionit evropian për vitin 2016,2015,2014, 2013 dhe 2012;
- Rekomandime nga grupi i ekspertëve të lartë për çështje sistematike për sundimin e së drejtës që i dedikohen ndjekjes së komunikimeve të zbuluara në pranverën e vitit 2015, qershor viti 2015;
- Prioritete urgjente reformuese të Komisionit evropian për Republikën e Maqedonisë, qershor 2015;
- Përgatitje e programit të BE-së për mbështetje të sektorit të gjyqësorit, lcorrik 2014;
- Raport për evaluimin e GREKO për RM – rrethi i katërt, 2013;
- Raport për harmonizimin e GREKO për RM – rrethi i katërt, lcorrik 2016;
- Komisioni evropian për efilcasitetin e së drejtës (SEREJ) – Raport për evaluimin e Sistemeve evropiane të gjyqësorit dhe efikasitetit dhe cilësisë të së drejtës – botimi i fundit 2016 2014); dhe
- Mendim i Komisionit të Venedilcut për ligjet për përgjegjësi disiplinore dhe evaluim të gjykatësve në Republikën e Maqedonisë, dhjetor 2015.

6.4. Listë e dokumenteve ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqësorit

6.4.1. Dokumente të OKB-së për pavarësinë e gjyqësorit

- Deklarata universale për të drejtat e njeriut
- Traktati ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike
- Parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit dhe Procedura për zbatim efektiv të principeve themelore për pavarësinë e gjyqësorit
- Deklarata universale për pavarësinë e gjyqësorit

6.4.2. Dokumente të Këshillit të Evropës për pavarësinë e gjyqësorit

- Rekomandimi CM/Rec. (94) 12 i Komitetit të ministrave të vendeve anëtare për pavarësi, efikasitet dhe rolin e gjykatësve
- Rekomandimi CM/Rec. (2010) 12 i Komitetit të ministrave të vendeve anëtare për pavarësi, efikasitet dhe përgjegjësinë e gjykatësve
- Karta evropiane për statusin e gjykatësve (1998)
- Karta e madhe (MagnaCarta) e gjykatësve
- Komisioni i Venedikut, Raport për pavarësinë e sistemit gjyqësor (2010)
- Mendime të Këshillit konsultativ të gjykatësve evropian (19 mendime)
- Udhërrëfyes evropian për etikën dhe veprimin e prokurorëve publik (Udhërrëfyes nga Budapesti i miratuar në konferencën e përgjithshme të prokurorëve të Evropës nga viti 2005)

6.4.3. Dokumente tjera për pavarësinë e gjyqësorit

- Karta universale e gjykatësve
- Karta gjyqësore në Evropë

- Mt. Scopus standarde të miratuara dhe të rishilcuara ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqësorit
- (Bengalor) Kodelcs për sjelljen e gjykatësve
- Rrjeti evropian i këshillave gjyqësor, Zhvillim i standardeve minimale gjyqësore I-V (përzgjedhje, vlerësim, pavarësi, procedura disiplinore, etj.)

6.5. Praktika e GJNDN